

RAPORTI PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE  
NJRËZORE 2008-2010  
*Shtator 2008 – Maj 2009*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Ministria e Brendshme**

**Zëvendësministri**

**Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz**

**RAPORTI PËR REALIZIMIN E  
STRATEGJISË KOMBËTARE SHQIPTARE TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË  
QENIEVE NJRËZORE  
Shtator 2008 – Maj 2009**

*Tiranë, Gusht 2009*

## PASQYRA E LËNDËS

Hyrje .....	4
A. Ndjekja dhe Drejtësia Penale .....	6
1. Ushtrimi i ndjekjes penale .....	6
1.1. Profili i Trafikimit në Njerëz .....	6
1.2. Informacion statistikor në lidhje me hetimin dhe gjykimin.....	7
1.3. Hetimet Financiare .....	11
2. Rritja e kapaciteteve dhe njohurive të strukturave të zbatimit të ligjit – Trajnime.....	12
3. Rritja e bashkëpunimit me vendet e tjera.....	14
4. Lufta kundër korrupsionit dhe përfshirjes së strukturave të zbatimit të ligjit në veprat penale të trafikimit në njerëz dhe vepra të tjera të lidhura me të .....	17
5. Përmirësimi i kuadrit ligjor:.....	18
6. Sugjerime dhe rekomandime .....	19
6.1. Rekomandime për ndryshime ligjore (propozuar nga GJKR):.....	20
B. Mbrojtja Dhe Asistenca e Viktimave .....	22
1. Funksionimi i plotë i Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR).....	23
1.1. Autoriteti Përgjegjës .....	24
2. Identifikimi i të gjithë personave të trafikuar dhe referimi i tyre i menjëhershëm tek shërbimet e ndihmës; identifikimi i të gjitha formave të shfrytëzimit.....	25
2.1. Baza e të Dhënave për Viktimat e Trafikimit .....	25
2.2. Identifikimi i trafikimit të brendshëm.....	27
2.3. Identifikimi i rasteve në Pikat e Kalimit Kufitar .....	28
2.4. Nxitja e vetë-identifikimit;.....	29
3. Për fëmijët.....	32
3.1. Ngritja e Linjës Kombëtare Telefonike për Fëmijë në Shqipëri:.....	32
4. Ofrimi i ndihmës dhe mbrojtjes gjithëpërfshirëse sociale për të gjithë personat e trafikuar, në përputhje me nevojat individuale dhe pavarësisht nga vullneti i tyre për të bashkëpunuar me autoritetet dhe nxitja e rehabilitimit dhe përfshirjes sociale të personave të trafikuar .....	32
4.1. Qendrat Pritëse për Viktimat e Trafikimit .....	33
4.2. Ngritja e qendrave të reja shërbimesh komunitare për fëmijë: .....	34
4.3. Trajnimet e organizuara me stafin konsullor në përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit: .....	35
5. Sigurimi i mbrojtjes së veçantë për viktimat, të cilat paraqiten si dëshmitarë në procedimet penale .....	36
5.1. Investime dhe programe.....	36
5.2. Mbrojtja e viktimave të huaja .....	38
Rekomandime dhe sugjerime.....	38
C. Parandalimi.....	40
1. Ndërgjegjësimi publik.....	40
2. Punësimi.....	41
2.1 Zyrat Rajonale të Punës .....	42
2.2 Formimi profesional.....	43
2.3 Programet e nxitjes së punësimit .....	44

2.4 Agjensitë Private të Punësimit .....	45
2.5 Vet-punësimi .....	45
2.6 Punësimi jashtë vendit .....	47
3. Arsimimi .....	48
3.1 Kurrikulat mësimore dhe temat mbi trafikimin .....	48
3.2 Pjesëmarrja në arsimin e detyrueshëm.....	48
3.3 Sistemi i “mbrojtjes të fëmijëve” në shkolla.....	49
4. Regjistrimi i popullsisë .....	50
4.1 Regjistrimi i Komunitetit Rom .....	51
5. Shfrytëzimi i punës së fëmijëve.....	51
5.1 Inspektoriati Shtetëror i Punës (ISHP):.....	52
6. Ambasadat shqiptare si mekanizma ndihmës në parandalimin e rasteve të trafikimit .....	53
7. Ngritje kapacitetesh për forcimin e mekanizmave koordinues dhe referues për identifikimin e personave në rrezik në nivel lokal.....	54
8. Aktivitetet lokale - Komitetet Rajonale Anti-Trafik (KRAT) .....	54
9. Aktivitete të tjera.....	55
9.1. Dita kombëtare Antitrafik- 18 Tetor, 2008 .....	55
9.2. Linja telefonike pa pagesë 0 800 1212 .....	56
9.3. Stendat në Pikat kufitare .....	56
9.4 Promovimi për zbatimin e Kodit të Sjelljes në Turizëm.....	56
Konkluzione .....	57
Aneks 1 .....	59
Aneks 2 .....	61

## HYRJE

Arsyet e shfrytëzimit nga trafikimi janë të shumta. Ndër to varfëria dhe pamundësia për të punuar, për të arsimuar fëmijët, për të patur një jetesë minimale, mungesa e informacionit mbi të janë faktorë shtytës që çojnë gratë, burrat dhe fëmijët drejt trafikimit. Këta persona bëhen pre e premtimeve mashtruese të shfrytëzuesit, premtime të cilat lidhen me një jetë më të mirë. Pranimi i këtyre ofertave mashtruese i bën këta individë të bien në kurthin e errët të shfrytëzimit e trafikimit.

Për të parandaluar këtë fenomen, trafikimin e qenieve njerëzore duhet një vizon i qartë se cilat do të ishin ndërhyrjet e nevojshme parandaluese e shoqëruar nga një vullnet i fortë i qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe përpjekje të koordinuara mirë. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010 adreson më së miri shkaqet kryesore që çojnë drejt fenomenit të trafikimit. Ky dokument përmbledh përjasjen që institucionet shqiptare duhet të kenë në fushën e parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Duke qenë se Shqipëria është një vend origjine për viktimat e trafikimit, aktivitetet parandaluese të parashikuara në Plan Veprim adresojnë shkaqet kryesore që çojnë një person të bëhet viktimë e trafikimit, gjithashtu aktivitete të cilat shenjëstrojnë shfrytëzuesit apo trafikantët janë prezent.

Viti 2008 dhe në vazhdim ka qenë një periudhë e ngarkuar me aktivitete dhe veprimtari të cilat kanë patur në fokus parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Nëpërmjet këtij raporti do të gjeni informacion që i përket kryesisht periudhës shtator 2008 – maj 2009 që përkon edhe me hyrjen në fuqi të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010 dhe fillimin e zbatimit të saj.

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010 strukturat e zbatimit të ligjit në bashkëpunim edhe me aktorët e tjerë i kanë intensifikuar përpjekjet e tyre në drejtim të ndjekjes penale dhe dënimit të autorëve nëpërmjet proceseve të rregullta gjyqësore. Gjatë gjithë veprimtarisë së tyre këto struktura i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë trajtimit të viktimave të trafikimit duke u bazuar në të drejtat e njeriut dhe duke vlerësuar si më të rëndësishëm interesin e viktimës apo palës së dëmtuar nga veprat penale të trafikimit.

Gjatë kësaj periudhe është punuar më tepër në drejtim të rritjes së efikasitetit të punës, profesionalizmit dhe rritjes së bashkëpunimit të strukturave ligjore dhe specialistëve midis tyre dhe autorëve të tjerë për procesin e hetimit, sigurimit të provave me qëllim dënimin e autorëve dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Ky raport për zbatimin e një dokumenti shumë të rëndësishëm kombëtar, përfshin informacion si për arritjet dhe problematikat e hasura në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010, ashtu edhe për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit, 2008-2010.

Informacioni në vijim është i ndarë në tre kapituj; Ndjekja dhe Drejtësia Penale, Mbrojtja dhe Parandalimi, respektivisht sipas shtyllave të të dy dokumenteve strategjikë. Shtylla e Bashkërendimit, është shkruar me kapitujt e tjerë duke u bërë pjesë e drejtimeve të mësipërme. Në përmbajtjen e këtij raporti do të gjeni edhe të dhëna statistikore për periudhën që raportohet dhe disa rekomandime me qëllim përmirësimin e punës dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010.

Materiali në vijim është një produkt i një pune në grup, ku pa informacionin e marrë nga të gjithë aktorët e përfshirë në Strategji nuk do të kishim këtë pamje të qartë të hapave që po ndërmerren në kuadër të progresit jo vetëm në drejtim të luftës dhe parandalimit të trafikimit në njerëz, por edhe për integrimin e plotë të vendit në strukturat evropiane. Si rrjedhim, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz, falenderon të gjithë anëtarët e Task Forcës Antitrafik, të cilët kanë punuar ngushtësisht me stafin e Njesisë Antitrafik për të hartuar këtë raport.

## **A. NDJEKJA DHE DREJTËSIA PENALE**

Në vijim të këtij kapitulli do gjeni një informacion më të plotë për veprimtarinë e institucioneve dhe strukturave të zbatimit të ligjit në drejtim të ndjekjes dhe drejtësisë penale me qëllim parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të njerëzve.

### **1. Ushtrimi i ndjekjes penale**

#### ***1.1. Profili i Trafikimit në Njerëz***

Edhe për periudhën 2008 – maj 2009 Shqipëria klasifikohet si vend origjine për trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e njerëzve. Më i përhapur është kontrabandimi i njerëzve me qëllim mbërritjen e tyre kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian për t'u bashkuar me pjesëtare të tjerë të familjeve dhe për qëllime punësimi. Në rastet e trafikimit të femrave pjesa më e madhe e tyre ka për destinacion Italinë, Greqinë dhe më rrallë Spanjën, Zvicrën, Francën dhe Kosovën. Linjat e trafikimit dhe kontrabandimit të njerëzve janë nëpërmjet Greqisë, duke shfrytëzuar kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror në këmbë dhe pas mbërritjes në Greqi mund të pajisen me dokumente të falsifikuara greke ose të vendeve të tjera dhe udhëtojnë për në vendet e destinacionit që janë kryesisht vende të Bashkimit Evropian. Një linjë tjetër e përdorur është Mali i Zi, duke shfrytëzuar faktin që me këtë vend nuk ka regjim vizash. Nga Mali i Zi kalojnë në Kroaci, Slloveni dhe destinacioni i fundit janë vendet e BE-së.

Megjithëse në rënie, më i përhapur ngelet sërish trafikimi i femrave me qëllim shfrytëzimin për prostitucion. Femrat rekrutohen nëpërmjet mashtrimit, martesave fiktive, premtimit për punësim dhe një jetë më të mirë etj. Fillimisht trafikantët i trajtojnë miqësisht viktimat, duke bashkëjetuar me to, madje në mjaft raste kanë shkuar edhe në familje duke lidhur martesë ligjore apo martesë fakti. Më pas me dhune fizike ose psikologjike i kanë detyruar "*bashkëshortet*" ose "*bashkëjetueset*" e tyre që të prostitutojnë.

Rrethanat që i kanë ndërgjegjësuar viktimat për të denoncuar tutorët e tyre kanë qenë nga më të ndryshmet, por në fakt pas kallëzimit rezulton se ato janë gjetur nën presion të jashtëzakonshëm gjë që ka sjellë në disa raste edhe ndryshimin e thënieve të tyre para gjykatës, apo edhe refuzimin e tyre për të dëshmuar.

Më të rrezikuar për t'u trafikuar janë femrat dhe fëmijët nga familje me nivel të ulët ekonomik, social dhe kulturor si dhe banorë të zonave të thella tek të cilët ka mungesë të theksuar informacioni. Për sa u përket fëmijëve, më të rrezikuar janë ata të Komunitetit Rom.

## 1.2. Informacion statistikor në lidhje me hetimin dhe gjykimin

Aktiviteti kriminal i trafikimit të qenieve njerëzore në pjesën më të madhe të rasteve është veprimtari kriminale me karakter transnacional, por ekziston edhe trafikimi i brendshëm. Përgjithësisht në çështjet e hetuara për këtë qëllim nuk janë evidentuar grupe apo organizata të mirëfillta kriminale por, veprimtari kriminale e cila kryhet nga individë të veçantë për të cilët në disa raste ka të dhëna se janë marrë dhe më parë me këtë veprimtari. Në pjesën më të madhe të rasteve subjektet kriminale veprojnë individualisht, të paorganizuar, por ka dhe raste sporadike ku në trafikim bashkëpunojnë edhe persona të afërm ose familjarë të viktimës.

Sipas informacionit të marrë nga Policia e Shtetit, gjatë vitit 2008 janë evidencuar 29 raste të procedimeve për çështje të trafikimit të qenieve njerëzore. Nga këto 24 raste të Trafikimit të Femrave - neni 114/b i Kodit Penal dhe 5 raste për Trafikim të të Miturve - neni 128/b i Kodit Penal.

### Statistikat e Sektorit kundër Trafikeve të Paligjshme për periudhën 01.09.2008 – 30.04.2009

Vepra Penale	Evidencuar	Autorë	Arrestuar	Gjendje të Lirë	Kërkim	Ndaluar
Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	49	95	53	9	9	24
Shfrytëzim Prostitucioni në Rrethana Rënduese	12	16	1	3	4	8
Shfrytëzimi i prostitucionit	9	11	8	1		2
Trafik fëmijësh	1	2		2		
Trafik femra	7	8		4	1	3
<b>SHUMA</b>	<b>78</b>	<b>132</b>	<b>62</b>	<b>19</b>	<b>14</b>	<b>37</b>

Sipas të dhënave të marra nga **Prokuroria e Krimeve të Rënda** në periudhën shtator 2008 – prill 2009 janë regjistruar gjithsej 7 procedime penale të reja për veprën penale të parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal “Trafikimi i femrave” me katër të pandehur dhe 2 procedime penale në lidhje me nenin 128/b të Kodit Penal “Trafikimi i të miturve”, ku ka një të pandehur.

Po në këtë periudhë janë nisur për gjykim tre procedime penale me tre të pandehur. Dy procedime lidhen me veprën penale të parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal “Trafikimi i femrave” dhe një procedim për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal “Trafikimi i të miturve”.

Sipas statistikave vjetore të Prokurorisë për Krimet e Rënda, gjatë vitit 2008 janë regjistruar gjithsej 13 procedime për nenin 114/b të K.P.<sup>1</sup>. “Trafikimi i femrave”, dhe 6 procedime për nenin 128/b të K.P. “Trafikimi i të miturve”. Tre prej këtyre 19 çështjeve i janë dërguar për kompetence lëndore prokurorive të tjera. Për sa i përket kohës së kryerjes së veprave një pjesë e këtyre krimeve janë të ndodhura disa vite më parë në kohë si 2004, 2005 e të denoncuara më vonë por ka edhe nga ato më afër si 2007 apo 2008.

Për sa i përket shfrytëzimit të fëmijëve përsëri episodet lidhen me vite të shkuara si 2003-2004 por edhe më të reja si 2007 apo 2008. Në përgjithësi fëmijët i përkasin komunitetit rom, të cilët shfrytëzohen nga të afërmit e tyre për të lypur në Greqi. Ka edhe një rast të shfrytëzimit brenda vendit.

Për sa i përket gjyqimit, të dhënat ndodhen në statistikat që jep gjykata, por tendenca është në kërkimin e masave të larta të dënimit.

**Edhe Gjykata e Shkallës së Pare për Krime të Rënda**, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj në zbatim edhe të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i ka kushtuar vëmendje të veçante gjyqimit të veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

Nga të dhënat e regjistruara, gjatë periudhës 01.09.2008 – 30.04.2009, janë trajtuar 15 çështje me objekt vepra penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, prej të cilave 8 janë përfunduar dhe 7 janë ende në gjykim. Në këto çështje penale janë sjelle për gjykim gjithsej 39 persona, 23 prej të cilëve për veprat penale të parashikuar nga neni 114b i K.P. “Trafikimi i femrave” dhe neni 128b i K.P. “Trafikimi i të miturve”, ndërsa 16 prej tyre janë akuzuar për kontrabandimin e personave sipas nenit 298/3 të K.P. Nga numri total i personave që kanë ardhur për gjykim në GJKR-Shkalla e Parë për periudhën shtator 2008 – prill 2009, rezulton se 27 prej tyre janë gjykuar dhe janë gjetur fajtor, ndërsa 12 persona janë ende në gjykim.

Nga të dhënat statistikore rezulton se ka rënie të numrit të procedimeve të ardhura për gjykim për veprat penale të trafikimit. Nëse në vitet e para të krijimit të kësaj gjykate, në periudhën 2004-2006, numri i çështjeve penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, zinte rreth 50% të numrit total të çështjeve, tashmë këto lloj çështjesh, përfshijnë më pak se 10% të punës së GJKR<sup>2</sup>-së. Megjithatë duhet theksuar se për çështjet e gjykuara është rritur cilësia dhe efektiviteti i punës në drejtim të dënimit të trafikantëve si dhe realizimit të proceseve gjyqësore të drejta bazuar në ligj dhe të drejtat e njeriut përfshirë edhe atë për një proces të rregullt gjyqësor. Gjatë zhvillimit të

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

<sup>2</sup> Gjykata e Shkallës së Pare për Krime të Rënda



procesit është treguar një kujdes i veçantë për viktimat e trafikimit sidomos për ato që kanë bashkëpunuar me organet e drejtësisë.

Sipas statistikave rezulton se në periudhën objekt analize, në GjKR (Shkalla e parë) kanë ardhur për gjykim dhe janë regjistruar për herë të parë 4 çështje penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

Ndërkohë nga statistikat konstatohet se në periudhën shtator 2008 – prill 2009, krahas çështjeve të sipërcituara, kanë qenë në gjykim dhe janë dhënë vendime përfundimtare për 8 çështje penale me 27 autorë nga të cilat 5 për trafikim femrash (neni 114b) me gjithsej 9 autorë dhe 2 çështje për ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit (neni 298 i K.P) me 16 autorë.

Krahas këtyre çështjeve, nga GjKR Shkalla e Parë, me qëllim parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar janë shqyrtuar edhe një numër i konsiderueshëm çështjesh që kanë patur si objekt sekuestrimin e konfiskimin e pasurive të të akuzuarve, prej të cilave 4 çështje kanë patur si objekt pasurinë e personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale që lidhen me trafikimin e femrave.

Sipas statistikave të **Ministrisë së Drejtësisë** për veprat penale të trafikimit të njerëzve për vitin 2008 dhe për 3 mujorin e parë të vitit 2009 kemi këto të dhëna:

#### Statistika për vitin 2008:

Gjykata	Neni	Të mbartura	Ardhur të reja	Ardhur pas prishjes	Vendim pafajësie	Vendim fajësie	Vendosur Mos kompetence	Përfunduar	Pa përfunduar
Krimet e Rënda	110/a2	0	1	0	0	0	0	0	1
	114/b1	2	1	1	0	3	0	3	1
	114/b2	5	0	3	0	5	1	6	2
	114/b3	2	4	0	0	2	0	2	4
	128/b1	0	3	0	0	3	0	3	0
	128/b2	0	1	0	0	0	0	0	1
	128/b3	2	1	0	0	2	0	2	1
	128/b4	2	0	0	0	2	0	2	0
<b>Gjithsej</b>		<b>13</b>	<b>11</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>17</b>	<b>1</b>	<b>18</b>	<b>10</b>

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se për **nenin 110/a2** ka **një çështje** të papërfunduar për vitin 2008 e cila është mbartur për 3 mujorin e parë të vitit 2009. Për nenet **114/b** -

**114/b5** ka një total prej **18 çështjesh penale**, prej të cilave **11 rezultojnë të përfunduara** dhe **7 të papërfunduara**, të cilat mbarten në 3 mujorin e I të vitit 2009. Vihet re se për **nenin 114/b2** Gjykata e Krimeve të Rënda ka vendosur **1 çështje për moskompetencë**. Për **nenin 128/b – 128/b5** ka një total prej **9 çështjesh penale**, prej të cilave **7 rezultojnë të përfunduara**, ndërkohë që **2 rezultojnë të papërfunduara** dhe do të mbarten në 3 mujorin I të vitit 2009.

**Kohëzgjatja për 18 çështjet e përfunduara** është si më poshtë:

- Deri në 2 muaj            2 çështje
- 2-6 muaj                4 çështje
- 6 muaj – 1 vit            9 çështje
- Mbi 1 vit                 3 çështje

Nga **18 çështjet të përfunduara** rezulton se ka **12 të dënuar** nga të cilët:

- 4 të dënuar              2-5 vjet,
- 3 të dënuar              5-10 vjet
- 9 të dënuar              10-25 vjet.

Për vitin 2008, bazuar në evidencat statistikore të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, rezultojnë **28 çështje penale për gjykim**, prej të cilave **18 janë të përfunduara** ndërsa **10 janë të papërfunduara**.

**Për 3 mujorin e parë të vitit 2009:**

Gjykata	Neni	Të mbartura	Ardhur të reja	Ardhur pas prishjes	Vendim pafajësie	Vendim fajësie	Përfunduar	Pa përfunduar
Krime të	110/a2	1	0	0	0	0	0	1
Rënda	114/b1	1	0	1	0	0	0	2
	114/b2	2	0	0	0	0	0	2
	114/b3	4	0	0	0	2	2	2
	128/b1	0	0	0	0	0	0	0
	128/b2	1	0	0	0	0	0	1
	128/b3	1	0	0	0	0	0	1
	128/b4	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>		<b>10</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>9</b>

Sipas të dhënave të mësipërme për veprën penale të përcaktuar në nenin **110/a d-110/a5** për 3 mujorin e I të 2009 rezulton **1 çështje e mbartur** nga viti 2008, e cila është e **papërfunduar** dhe do të jetë e mbartur për 3 Mujorin e II të 2009. Për nenet **114/b – 114/b5** ka një total prej **8 çështjesh penale**, prej të cilave **2 rezultojnë të përfunduara**, ndërkohë që **6 rezultojnë të papërfunduara** dhe do të mbarten për 3 Mujorin e II të vitit 2009. Për nenet **128/b – 128/b5** ka një total prej **2 çështjesh penale**, të cilat **rezultojnë të papërfunduara** dhe do të mbarten për 3 Mujorin e II të vitit 2009.

**Kohëzgjatja për 2 çështje të përfunduara** është si më poshtë:

- 6 muaj – 1 vit            1
- Mbi 1 vit                    1

Nga **2 çështje të përfunduara** rezulton se ka **3 të dënuar** 10-25 vjet.

Nga të dhënat statistikore për 3 mujorin e I të Vitit 2009 rezulton se Gjykata e Krimeve të Rënda ka shqyrtuar **10 çështje penale** në total, prej të cilave **10 çështje të mbartura** nga viti 2008, nga këto **1 është e ardhur pas prishjes së vendimit**. Çështjet e papërfunduara janë të mbartura në 3 Mujorin e I të vitit 2009, nga të cilat **1 rezulton e përfunduar** dhe **9 çështje të papërfunduara**. Çështjet e papërfunduara do të mbarten në 3 Mujorin e II të vitit 2009.

### **1.3. Hetimet Financiare**

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare Antitrafik 2008-2010 dhe planit të saj të veprimit **Ministria e Financave** dhe strukturat e saj të vartësisë kanë punuar kryesisht në drejtim të rritjes së hetimeve financiare dhe përdorimit të tyre në hetimet kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjatë periudhës së raportimit nga ana e Njesisë së Inteligjencës Financiare – Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP) janë referuar për investigime të mëtejshme pranë autoriteteve të zbatimit të ligjit gjithsej 59 raste. Në vazhdimësi do të punohet më këto autoritete për rritjen e numrit të referimeve.

Për sa i përket bashkëpunimit për hetimet financiare midis Njesisë së Inteligjencës financiare, Prokurorisë dhe Drejtorisë kundër Krimin Ekonomik në PSH janë zhvilluar rreth 34 aktivitete trajnuese ku kanë qenë përfitues strukturat e përmendura më sipër dhe Banka e Shqipërisë. Këto aktivitete janë zhvilluar në kuadër të Projektit të binjakëzimit me homologët gjermanë.

Më datë 30.10.2008 është zhvilluar një takim me temë “Hartimi i një Strategjie Kombëtare afatmesme dhe afatgjatë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit. Ndërsa në takimin e zhvilluar më datë 25.11.2008 me

pjesëmarrjen e grupit teknik ndër/institucional është diskutuar mbi rritjen e shpejtësisë dhe mundësisë së aksesit në bazën e të dhënave nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Më datë 16.12.2008 është mbledhur Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave me qëllim analizimin e masave të marra nga çdo institucion. Ky komitet kryesohet nga Kryeministri dhe në të bëjnë pjesë si anëtarë: MF, MPJ, MM, MB, MD, PP, BSH, SHISH dhe ILDKP.

## **2. Rritja e kapaciteteve dhe njohurive të strukturave të zbatimit të ligjit – Trajnime**

Gjatë vitit 2008 dhe në vazhdim, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (ZKKA) - Njësia Antitrafik në bashkëpunim me OJF-ë dhe organizata ndërkombëtare ka organizuar një seri trajnimesh për strukturat e zbatimit të ligjit dhe aktorët e tjerë të përfshirë në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Fillimisht janë organizuar trajnime me oficerë të policisë dhe ofrues të shërbimeve sociale. Afërsisht, janë trajnuar 150 oficerë të policisë antitrafik, policisë kufitare dhe të migracionit, specialistë të Seksioneve të Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje, si dhe të policimit në komunitet në lidhje me Mekanizmin Kombëtar të Referimit dhe udhëzimin e MKR-së për identifikimin e viktimave të trafikimit si dhe teknikat e intervistimit. Në këto trajnime Policia e Shtetit përpiloi planet e trajnimit, materialet për prezantim si dhe disa teste për pjesëmarrësit. Temat e prezantuara në këto trajnime janë tashmë pjesë e Kurrikulave të Akademisë së Policisë.

Aktualisht në strukturat anti-trafik në shkallë vendi janë të emëruara 17 punonjëse policie femra të cilat janë trajnuar në lidhje me teknikat e intervistimit dhe identifikimin e viktimave të trafikimit sipas Mekanizmit Kombëtar të Referimit.

Sipas statistikave deri në muajin prill 2009 janë trajnuar 190 punonjës policie të nivelit të parë të drejtimit, të cilët kanë marrë njohuri për mbledhjen e informacionit hetimor. Janë trajnuar rreth 32 punonjës policie të sektorit të Analizës dhe Informacionit kriminal, me qëllim rritjen e aftësive analitike të informacionit kriminal. Janë trajnuar 1569 punonjës policie të nivelit zbatues, të cilëve u është siguruar trajnim mbi mbledhjen e informacionit kriminal. 143 janë punonjës policie të rinj dhe 1284 në detyrë. Këto trajnime janë organizuar nga Sektori Kundër Trafiqueve të Paligjshme në bashkëpunim me ZKKA dhe ICITAP.

Deri në muajin prill 2009 janë kryer rreth 30 trajnime për dhunën në familje dhe aspekte të trafikimit të fëmijëve dhe të të rriturve. Në këto trajnime janë përfshirë rreth 900 punonjës policie. Trajnimet janë kryer nga Policia e Shtetit me mbështetjen e UNDP-së.

Janë organizuar trajnime në kuadër të Instrumentit të Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit – Komisioni Evropian (TAIEX) me personelin femër të Policisë Kufitare dhe të Migracionit - PKM (19 punonjëse) për identifikimin e viktimave të trafikimit dhe përsosjen e teknikës së intervistimit.

Në çdo Stacion PKM janë organizuar trajnime në terren nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në bashkëpunim dhe me struktura të tjera dhe OJF.

Shkolla Baze e Policisë ka përgatitur kurrikula standarde trajnimi dhe të përditësuara çdo vit ku jepen njohuri për identifikimin dhe intervistimin e viktimave të krimit si dhe mbledhjen e informacionit kriminal. Këto tema mësimore trajtohen për rreth 34 orë mësimore. Deri në muajin prill këtë program e kanë përfunduar rreth 1600 punonjës policie.

Me shkresën nr. 7781 të datës 26 nëntor 2008 nga ana e Drejtorisë Kundër Krimit të Organizuar i është propozuar Departamentit të Trajnimeve institucionalizimi i materialit të përdorur për trajnime, në lidhje me teknikat e intervistimit dhe identifikimin e viktimave të trafikimit, të përgatitur nga Sektori Kundër Trafikeve të Paligjshme në bashkëpunim me ICITAP, duke e përfshirë atë në kurrikulat e Akademisë së Policisë për vitin 2009.

Gjithashtu, Departamenti i Trajnimit në Policinë e Shtetit po harton një program trajnimi të specializuar i cili do të përfshijë punonjësit e policisë të cilët punojnë në strukturat e hetimit të trafikut të paligjshëm si dhe ata që do të emërohen rishtas në këto struktura.

Policia e Shtetit në bashkëpunim me Policinë Belge, Policinë Angleze dhe Policinë Austriake gjatë periudhës së raportimit ka zhvilluar rreth 4 trajnime ku janë përfshirë rreth 66 punonjës policie të strukturave të luftës kundër trafikut të paligjshëm. Në këto trajnime janë diskutuar çështje që kanë të bëjnë me trajtimin e viktimave të trafikut të paligjshëm.

Në kuadër të rritjes së profesionalizmit dhe njohurive në fushën e luftës kundër trafikimit të njerëzve një rol shumë të rëndësishëm ka luajtur edhe **Shkolla e Magjistraturës**. Gjatë periudhës së raportimit Shkolla e Magjistraturës ka patur një veprimtari mjaft të ngjeshur në organizimin e trajnimeve për strukturat e zbatimit të ligjit, kryesisht për gjyqtarët dhe prokurorët. Shkolla e Magjistraturës e ushtron veprimtarinë e saj bazuar në dy programe bazë siç janë Programi i Formimit Fillestar për prokurorët dhe gjyqtarët e rinj, si dhe Programi i Formimit Vazhdues. Në programin e formimit vazhdues marrin pjesë prokurorë, gjyqtarë dhe oficerë të policisë gjyqësore në detyrë por edhe aktorë të tjerë siç mund të jenë avokatët. Disa nga këto trajnime kanë patur për objekt tema të veçanta për luftën kundër trafikimit në njerëz,

mbrojtjen e viktimave të trafikimit si dhe rritjen e njohurive për veprat penale të trafikimit duke i dalluar ato nga veprat tjera të ngjashme.

Gjatë vitit akademik 2008-2009 në Programin e Trajnimit Vazhdues janë hartuar tri module trajnime për rritjen e njohurive bazë të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Për dy modulet e para janë realizuar gjithsej 8 sesione trajnimi nëpërmjet të cilave janë trajnuar 210 gjyqtarë dhe prokurorë<sup>3</sup>. Brenda muajit maj është realizuar edhe sesioni trajnues për modulin e 3-të të trajnimit.

Me qëllim institucionalizimin e plotë të këtyre trajnimeve janë përgatitur dhe ekzistojnë dosje me materialet e nevojshme të cilat janë tashmë pjesë e kurrikulave të trajnimeve në shkollë. Këto materiale trajtojnë çështje të rëndësishme mbi të drejtat e njeriut dhe tema të veçanta në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore të orientuar tek viktimat si dhe ndikojnë drejtpërdrejtë në ngritjen e kapaciteteve të të gjitha strukturave të zbatimit të ligjit.

### **3. Rritja e bashkëpunimit me vendet e tjera**

Për të patur sukses në luftën kundër trafikimit të njerëzve është i domosdoshëm një bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet strukturave të zbatimit të ligjit dhe aktorëve të tjerë anti-trafik, por në mënyrë të veçantë me vendet e tjera.

Për këtë qëllim gjatë vitit 2008 dhe në vazhdim të 2009 është punuar për të rritur dhe institucionalizuar bashkëpunimin sidomos me vendet fqinje por edhe me vendet e tjera të tranzitit dhe destinacionit. Janë organizuar takime të rregullta me strukturat homologe kryesisht të vendeve fqinjë.

Në zbatim të marrëveshjeve dhe protokolleve të bashkëpunimit me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Greqinë, janë zhvilluar takime në tre nivelet ku janë diskutuar çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me luftën kundër trafikimit dhe kontrabandimit të njerëzve. Për këtë qëllim zhvillohen patrullime të përbashkëta të Policive Kufitare. Janë zhvilluar disa operacione të përbashkëta me Greqinë për parandalimin e kalimeve të paligjshme të kufirit (Vetëm gjatë vitit 2008 janë zhvilluar 18 operacione). Takime të tilla të rregullta në tre nivelet janë zhvilluar edhe me Policinë Kufitare dhe të Migracionit të Kosovës.

Drejtoria Kundër Krimin të Organizuar në Policinë e Shtetit ka marrë pjesë në veprimtaritë rajonale dhe ka kryer operacione të përbashkëta të organizuara nga Qendra SECI – “*South-East European Cooperative Initiative*”. Konkretisht me datë 19 maj

---

<sup>3</sup> Informacion më të detajuar do të gjeni në Aneks.

Sektori Kundër Trafikeve të Paligjshme ka marrë pjesë në takimin e 16-të të Task Force “Mirage” në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore në qendrën SECI.

Sipas informacioneve të marra nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, në përgjithësi është synuar që hetimet të përfundojnë në një kohë sa më të shkurtër, por gjithmonë ngelet problem ekzekutimi i letërporosive.

Në përgjithësi për shumicën dërrmuese të çështjeve me objekt trafikimin e qenieve njerëzore ka letërporosi të dërguara autoriteteve të huaja ku ndodhen edhe provat kryesore në lidhje me aktivitetin kriminal. Përgjigjet për ekzekutimet e këtyre letërporosive zakonisht vonojnë mjaft në kohë duke sjelle shpesh herë edhe zvarritje të hetimeve dhe në disa raste duke vënë në rrezik të gjithë procesin. Nga autoritetet e huaja, ka një zvarritje të konsiderueshme në kohë në dhënien e përgjigjeve, por ky është një fenomen që ndodh rëndom në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Për vitin 2008 janë nisur 8 letërporosi nga të cilat 3 janë ekzekutuar, 2 (dy) nga Greqia dhe 1 (një) nga Kosova. Letërporositë e tjera janë nisur drejt Greqisë, Italisë dhe Francës.

Sipas Ministrisë së Drejtësisë si rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar është bërë e mundur realizimi me suksese i disa ekstradimeve. Kështu për vitin 2008 për shtetas të arrestuar jashtë shtetit dhe për të cilët është paraqitur kërkesa për ekstradim janë këto të dhëna :

- Për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i K.P. - **“Shfrytëzim prostitucioni”**, është paraqitur kërkesë për ekstradim për **17 shtetas**;
- Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i K.P. - **“Trafikim i personave”** është paraqitur kërkesë për ekstradim për **6 shtetas** ;
- Për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i K.P. - **“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur”** është paraqitur kërkesë për ekstradim për **1 shtetas**.

Të dhëna mbi shtetas të ekstraduar pas miratimit të kërkesës zyrtare për ekstradim të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2008 :

- Për veprën penale të parashikuar nga neni 114 i K.P. - **“Shfrytëzim prostitucioni”** janë ekstraduar në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara në ligj gjithsej **6 shtetas**;
- Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i K.P. - **“Trafikim personash”** janë ekstraduar **7 shtetas** ;
- Për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i K.P. - **“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”** janë ekstraduar **2 shtetas** britanikë.

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2009 janë arrestuar 23 persona me qëllim ekstradimin e tyre. Janë dorëzuar pranë autoriteteve shqiptare gjithsej 13 persona dhe 2 persona janë ekstraduar drejt autoriteteve të huaja.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dypalësh dhe ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit, janë parashikuar në Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së disa iniciativa ligjore afatshkurtra dhe afatmesme ndër të cilat do të veçonim:

- **Projektligji “Për Bashkëpunimin Gjyqësor Ndërkombëtar në Fushën Penale”**. Ky projektligj ka për qëllim rregullimin dhe saktësimin e të gjitha procedurave ligjore për realizimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në kuadrin e letërporosive ndërkombëtare, ekstradimeve nga jashtë dhe për jashtë, njohjes së vendimeve të huaja penale, transferimit të procedimeve penale, si dhe transferimin e personave të dënuar.
- **Projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Hagës “Për aksesin ndërkombëtar në drejtësi”**. Ky akt synon përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për anëtarësimin e shtetit shqiptar në akte dhe struktura ndërkombëtare me qëllim rritjen e forcimit dhe bashkëpunimit me shtetet e tjera, palë të këtyre akteve dhe strukturave.
- **Projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Hagës “Mbi procedurën civile”**. Ky akt synon përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për anëtarësimin e shtetit shqiptar në akte dhe struktura ndërkombëtare me qëllim rritjen e forcimit dhe bashkëpunimit me shtetet e tjera, palë të këtyre akteve dhe strukturave.
- **Projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Hagës “Mbi Njohjen dhe Zbatimin e vendimeve të huaja për çështjet civile dhe tregtare”**. Ky akt synon përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për anëtarësimin e shtetit shqiptar në akte dhe struktura ndërkombëtare me qëllim rritjen e forcimit dhe bashkëpunimit me shtetet e tjera, palë të këtyre akteve dhe strukturave.
- **Projektligji “Për ratifikimin e Protokollit Plotësues të Konventës së Konferencës së Hagës “ Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja për çështjet civile dhe tregtare”**. Ky akt synon përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për anëtarësimin e shtetit shqiptar në akte dhe struktura ndërkombëtare me qëllim rritjen e forcimit dhe bashkëpunimit me shtetet e tjera, palë të këtyre akteve dhe strukturave.
- **Projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Hagës “Mbi marrjen e provave jashtë territorit të shtetit në çështjet civile dhe tregtare”**. Ky akt synon përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për anëtarësimin e shtetit shqiptar në akte dhe struktura ndërkombëtare me qëllim rritjen e forcimit dhe bashkëpunimit me shtetet e tjera, palë të këtyre akteve dhe strukturave.
- **Nënshkrimi i Marrëveshjes “Për Bashkëpunimin gjyqësor” me Eurojust**. Kjo marrëveshje do të synojë të përcaktojë rregulla mbi bazën e të cilave do të funksionojë bashkëpunimi me *Eurojust* si dhe rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit gjyqësor me qëllim realizimin në kohë të ekzekutimit të vendimeve penale.



- **Nënshkrimi i Marrëveshjeve dypalëshe "Për bashkëpunimin gjyqësor"**. Këto akte do të përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e shtetit shqiptar dhe shtetit tjetër nënshkrues në fushën për të cilën do të lidhen. Nëpërmjet nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve synohet forcimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit të shtetit shqiptar me vendet e rajonit e më gjerë.

#### **4. Lufta kundër korrupsionit dhe përfshirjes së strukturave të zbatimit të ligjit në veprat penale të trafikimit në njerëz dhe vepra të tjera të lidhura me të**

Sipas informacioneve të marra nga strukturat e zbatimit të ligjit përfshirë edhe Prokurorinë për periudhën janar 2008 – prill 2009 nuk rezulton të ketë raste të përfshirjes së strukturave të policisë dhe të organeve të tjera të drejtësisë në vepra penale të trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjatë vitit 2008 janë evidentuar 3 procedime penale për "Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit", parashikuar nga neni 298 i K. Penal. Dy çështje janë në gjykim dhe njëra çështje është nën hetim.

Nga ana e SHKB-së është hartuar edhe plani i punës për vitin 2009 në zbatim të Strategjisë Kombëtare Anti-trafik 2008-2010 dhe planit të saj të veprimit duke e orientuar punën e saj në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe rritjes së performancës së strukturave të Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së detyrës.

Në veprimtarinë e tij edhe **Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH)** ka qenë mjaft aktiv dhe ka informuar në vazhdimësi Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz (ZKKA) lidhur me angazhimet që ka ky institucion në zbatim të Strategjisë Kombëtare Antitrafik 2008-2010. Në fillim të vitit 2009 nga ana e këtij institucioni është përgatitur dhe është përcjellë pranë ZKKA-së edhe plani i punës për vitin 2009, si dhe janë marrë masa për udhëzimin e strukturave të vartësisë mbi detyrat dhe angazhimet e tyre në zbatim të kësaj Strategjie. Strukturat e SHISH-it kanë qenë mjaft aktive edhe në aktivitetet e zhvilluara dhe përcjelljen e informacioneve edhe në nivel vendor duke bashkëpunuar ngushtë me strukturat vendore sidomos me Policinë, Prokurorinë dhe Komitetet Rajonale Anti-trafik.

Për periudhën shtator 2008 – prill 2009, SHISH ka iniciuar 9 bashkëpunime operacionale me Strukturat e Policisë së Shtetit, për parandalimin dhe ndërprerjen e veprimtarive që lidhen me favorizimin e emigracionit të paligjshëm, por edhe për vepra të tjera siç është edhe rasti i parandalimit të një rasti trafikimi të një të mituri. Si rezultat i kësaj pune është bërë i mundur arrestimi i 33 personave.

Për rastet e sipërpërmendura për periudhën shtator 2008 – prill 2009 SHISH ka dërguar 8 informacione drejtuar institucioneve kryesore si Presidenti i Republikës dhe Ministrisë së Brendshme – Policisë së Shtetit.

## 5. Përmirësimi i kuadrit ligjor:

Gjatë gjithë procesit të hartimit të Strategjisë dhe pas miratimit të saj është punuar në drejtim të identifikimit të nevojave për përmirësimin e legjislacionit dhe plotësimin e tij edhe me akte nënligjore. Gjatë vitit 2008 janë ndërmarrë disa iniciativa ligjore një pjesë e të cilave janë miratuar dhe të tjera janë në proces.

Ndryshimet më të rëndësishme ligjore të miratuara:

- Miratimi i **Ligjit nr. 9959 datë 17.07.2008 “Për të Huajt”**. Ky ligj rregullon plotësisht kompetencat e Policisë Kufitare dhe Migracionit për të grumbulluar, ruajtur dhe përpunuar të dhënat personale si dhe mbajtjen e evidencës për mbikëqyrjen e të huajve në përputhje me standardet e BE-së dhe me dispozitat e Ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale. Si risi e këtij ligji është edhe parashikimi i programeve të Integritimit Social të të Huajve në jetën dhe shoqërinë shqiptare. Në seksionin e lejeve të qëndrimit qartësohen procedurat dhe dokumentacioni për lëshimin e lejeve të qëndrimit, rregullat për t’u pajisur me leje qëndrimi për kategori të veçanta personash duke përfshirë edhe viktimat e trafikimit.
- **Ligji Nr. 10051, datë 29.12.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8737, datë 12.02.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar**, përbën një prej ligjeve më të rëndësishme, i cili synon së pari reflektimin e ndryshimeve kushtetuese për përcaktimin e mandatit të prokurorit të përgjithshëm. Ligji përmban rregulla që përmirësojnë rekrutimin, promovimin dhe përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve, marrëdhëniet hierarkike në prokurori dhe marrëdhëniet e organit të prokurorisë me të tretët. Neni 3/c i këtij ligji parashikon shprehimisht refuzimin për zbatimin e urdhrit të paligjshëm dhe procedurën që ndiqet në rast refuzimi. Këto parashikime, përmirësojnë ndjeshëm dhe e bëjnë më efektiv procesin hetimor.
- **Me Vendimin nr. 1083, datë 23.07.2008 të Këshillit të Ministrave është miratuar Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2008-2010**, si dhe dokumenti plotësues “**Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, viktimat e trafikimit**”, si komponentë të Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve dhe Terrorizmit, 2007-2013. Kjo Strategji është dokumenti më i rëndësishëm në nivel kombëtar në të cilin janë të përfshira të gjitha masat dhe objektivat që ka qeveria shqiptare për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
- **Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 480, datë 6.5.2009 “Për mbrojtjen e veçantë personale, familjare të gjyqtarëve, sigurimin e jetës dhe**

**pronës së tyre**". Ky akt, përcakton procedurat dhe kriteret për të siguruar mbrojtjen e veçantë të gjyqtarëve nga shteti, për veten, familjen dhe pronën, kur kjo kërkohet nga ai vetë, për rrethana serioze kërcënimi. Ky akt nënligjor është në zbatim të ligjit nr. 9110, datë 24.07.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda" si dhe ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

- Janë nxjerrë **akte nënligjore** për veprat penale që ndjekin oficerët e Policisë Gjyqësore - OPGJ dhe për procedurat standarde që duhet të kryhet me shtetasit që kthehen nga vendet e tjera ose kapen në tentativa për kalim të paligjshëm të kufirit. Në bazë të strukturës së PKM në çdo Drejtori Rajonale ka dhe funksionojnë strukturat e hetimit (OPGJ).
- Sipas Drejtorisë së Përgjithshme për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në Ministrinë e Brendshme projektligji "Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë" është në fazën përfundimtare të miratimit të tij (pritet mendimi edhe nga Ministria e Integritimit).

## 6. Sugjerime dhe rekomandime

Në këtë pjesë do të gjeni disa sugjerime dhe rekomandime të dhëna nga vetë institucionet dhe strukturat zbatuese të Strategjisë Anti-trafik 2008-2010 me qëllim përmirësimin e punës dhe realizimin me sukses të synimeve dhe objektivave të parashikuara në Strategji.

- Oficerët e policisë gjyqësore dhe Prokurorët që hetojnë aktualisht çështje penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, gjatë marrjes së deklarimeve nga të dëmtuarat, viktima të trafikimit, duhet të mbajnë në konsideratë njoftimin e tyre për të gjitha të drejtat që gëzojnë përfshirë edhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në të kundërt deklaratimet e dhëna prej viktimave të trafikimit, në fazën e hetimeve paraprake rrezikojnë të mos përdoren.
- Nga organi i Prokurorisë kërkohet aplikimi më me efikasitet **i procedurave për sigurimin e provës**, sipas **neneve 316 e vijues të K.P.P.**<sup>4</sup>, pra paraqitja menjëherë e të dëmtuarve, viktima të trafikimit që pranojnë të bashkëpunojnë me organet e drejtësisë, para gjykatës për të dhënë dëshminë, në kushtet kur ato ende nuk janë vënë nën presion apo tundim për tërheqjen e kallëzimit apo ndryshimin e thënies.
- Gjithashtu duhet të merren masa për mbrojtjen e viktimave të trafikimit sidomos të atyre që kanë pranuar për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë (informim mbi të drejtat ligjore dhe mundësinë e përfitimit të shërbimeve, përfaqësimin e tyre në gjykata dhe ofrimi i mbështetjes gjatë gjithë procesit të integritetit të tyre etj.).

<sup>4</sup> Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë

- Meqenëse në gjykimin e çështjeve penale në tërësi dhe në veçanti të atyre që kanë të bëjnë me “*Trafikimin e qenieve njerëzore*”, është i domosdoshëm rritja e bashkëpunimit me autoritet e huaja, rekomandohet aplikimi dhe shfrytëzimi i modeleve të mira siç është rasti i bashkëpunimit me Zyrat Policore të Vendeve Nordike, si shembull edhe për veprimtarinë e punës së zyrave të tjera policore që veprojnë në vendin tonë si dhe për ngritjen e funksionimit të zyrave policore pranë ambasadave tona në disa nga vendet me të cilat ne kemi më shumë probleme.

#### **6.1. Rekomandime për ndryshime ligjore (propozuar nga GJKR):**

- **Ndryshimi i K.Pr.P.**, përkatësisht të **nenit 158 të K.Pr.P.** Nga praktika gjyqësore është konstatuar se në kushtet kur viktimat e trafikimit, janë konsideruar si të dëmtuara nga vepra penale, organet e zbatimit të ligjit, në përgjithësi, nuk kanë aplikuar të drejtën e tyre sipas nenit 158 të K.Pr.P. Por në të vërtetë, në mënyrën se si është aktualisht e formuluar dispozita e mësipërme krijon paqartësi lidhur me të drejtën e të dëmtuarve për të mos dhënë deklarime në fazën e hetimeve paraprake apo dëshmi gjatë gjyqimit, në rastet kur deklarojnë se kanë bashkëjetuar apo kanë lidhur martesë me tutorët e tyre).
- Të ndërmerret iniciativa ligjore për **ndryshimin e nenit 6/2 të K.P.** dhe riformulimin e **nenit 7 të K.Pr.P.**, nën këndvështrimin e nenit 4 të Protokollit të 7, të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sipas të cilit: *“Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht, nga juridiksionet e të njëjtit shtet për një veprë për të cilën ai më parë ka qenë deklaruar i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar.....”*.
- Të përfundoje sa më shpejt **ligji i ri që trajton bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale**, meqenëse një pjesë e konsiderueshme e çështjeve penale që lidhet me trafikimin e qenieve njerëzore, fillon nga autoritetet tona të zbatimit të ligjit, pas letërporosive të dërguara nga autoritetet e huaja gjyqësore. Meqenëse nismat ligjore kërkojnë kohë është e nevojshme që të koordinohet dhe të përmirësohet puna që në fillim mes autoriteteve për hetimin e çështjeve dhe përcaktimin e palës që do ta gjykoje atë. Që në fazën e hetimeve paraprake, të synohet për transferimin e procedimit nga shteti i huaj në Shqipëri ose të ndodhë e kundërta.
- Është e domosdoshme që **të ripunohet tërësisht ligji nr. 9284 datë 30.09.2004 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar”** sepse si rrjedhojë e pasaktësive sidomos në aspektin procedural të tij, një numër i konsiderueshëm i vendimeve gjyqësore për sekuestrimin e pasurive nuk janë finalizuar me konfiskimin e tyre. Po kështu është e nevojshme që të saktësohet rrethi i veprave penale për të cilat aplikohet ligji 9284, efektet e këtij ligji kur ndryshon kualifikimi ligjor i veprës apo

jepet pafajësi për autorët e dyshuar si dhe mjaft probleme të tjera procedurale, detajimi i të cilave mund të bëhet në një moment tjetër.

- Nga Policia e Shtetit propozohet që të ngrihet një grup i përbashkët pune, me pjesëmarrjen e Prokurorisë, Policisë anti-trafik dhe specialistë të tjerë të Policisë së Shtetit për përgatitjen e një pakete/udhëzuesi hetimor për anti-trafikimin.

## **B. MBROJTJA DHE ASISTENCA E VIKTIMAVE<sup>5</sup>**

Institucionet shtetërore kanë përgjegjësinë kryesore për të ofruar shërbimet e lartpërmendura, për ta bërë sa më të lehtë procesin e ri-integrimit dhe për të shmangur stigmatizimin apo ri-viktimizimin e personave të trafikuar. Në këtë proces të gjatë dhe të vështirë institucionet shtetërore janë mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga organizatat jofitimprurëse, si dhe agjensitë e tjera joshtetërore, si organizatat ndërkombëtare prezente në Shqipëri. Kjo asistencë ka konsistuar në ndihmë direkte për personat e trafikuar, si strehim, këshillim, asistencë psikologjike, etj. dhe mbështetja e agjensive shtetërore qendrore dhe lokale për rritjen e kapaciteteve dhe forcimin e tyre për një shërbim sa më cilësor dhe konform standardeve ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2008 dhe 6-mujorit të parë të 2009-ës, ka patur përpjekje serioze nga ana e agjensive shtetërore për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për personat e trafikuar. Këto përpjekje janë fokusuar në konsolidimin e mekanizmave ekzistues dhe në përmirësimin e kapaciteteve që punojnë drejtpërdrejtë me personat e trafikuar. Gjithashtu, ka patur zhvillime dhe në aspektin e plotësimit të kuadrit ligjor dhe përmirësimit të procedurave përkatëse.

Me gjithë përpjekjet e deritanishme, nga vlerësimet e bëra bazuar tek treguesit e suksesit, mbrojtja e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe ndihma ndaj tyre mbetet një nga shtyllat më kritike të veprimit antitrafik në shkallë vendi.

Disa prej mangësive, që janë vërejtur gjatë kësaj periudhe raportimi për sa i përket mbrojtjes dhe asistimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të personave janë si më poshtë:

- mungesa e një veprimi të koordinuar, si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht, ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore përgjegjëse për mbrojtjen dhe asistencën e personave të trafikuar;
- përmirësimi i standardeve dhe procedurave të identifikimit; identifikimi i rasteve të trafikimit të brendshëm; identifikimi në pikat e kalimit kufitar; nxitja e vetë-identifikimit të personave të trafikuar;
- lehtësimi i kthimit, (ri) integrimit dhe përfshirjes sociale të personave të trafikuar dhe reduktimi i rrezikut të ri-viktimizimit e ritrafikimit të personave të trafikuar, si edhe sigurimi i ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat shqiptare jashtë vendit;
- përfshirja e viktimave të trafikimit në programin e veçantë për mbrojtjen e dëshmitarëve;

---

<sup>5</sup> Me mbrojtje dhe mbështetje të viktimave të trafikimit kuptojmë ofrimin e të gjitha shërbimeve, të cilat mundësojnë rehabilitimin dhe ri-integrimin e plotë të viktimës në komunitet. Me shërbime kuptojmë asistencën mjekësore, psikologjike, ligjore, strehim, mundësi punësimi etj.

- mungesa e burimeve të nevojshme financiare dhe burimeve njerëzore të mirë-trajnuara.

Në këtë kapitull raporti përqendrohet në përpjekjet e bëra në drejtim të: funksionimit të plotë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit; identifikimit të personave të trafikuar dhe të gjitha formave të shfrytëzimit dhe referimit të tyre të menjëhershëm tek shërbimet e ndihmës; ofrimit të ndihmës dhe mbrojtjes gjithëpërfshirëse sociale për të gjithë personat e trafikuar, në përputhje me nevojat individuale dhe pavarësisht nga vullneti i tyre për të bashkëpunuar me autoritetet; përfshirjes sociale të personave të trafikuar; si dhe sigurimit të mbrojtjes së veçantë për viktimat, të cilat paraqiten si dëshmitarë në procedimet penale.

## **1. Funksionimi i plotë i Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR)**

Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore me mbështetjen e Njesisë Antitrafik edhe gjatë periudhës në fjalë ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të orientuar punën e aktorëve të përfshirë në Mekanizmin Kombëtar të Referimit të Viktimave të Trafikimit. Kjo zyrë ka dërguar udhëzime të vazhdueshme dhe ka nxitur komunikimin midis anëtarëve të MKR-së për të siguruar zbatimin përpiktë të Marrëveshjes. Gjithashtu, është përpjekur të rrisë efektshmërinë e punës së Komiteteve Rajonale Antitrafik (KRAT), me qëllim edhe krijimin e mekanizmave vendor të referimit të viktimave të trafikimit duke u bazuar në MKR. Komitetet Rajonale janë nxitur për hartimin dhe zbatimin e projekteve nga ana e institucioneve vendore për grupet vulnerabël dhe në veçanti për personat e trafikuar. Po kështu, për një funksionim sa më efikas të tyre Zyra e Koordinatorit Kombëtar në bashkëpunim me OSBE-në dhe Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim” ka zhvilluar një seri trajnimesh me pjesëmarrjen e anëtarëve të KRAT-ve dhe aktorë të tjerë vendorë, të cilët kanë një rol aktiv në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave.

Gjatë muajve dhjetor 2008 – prill 2009 janë zhvilluar gjithsej 12 trajnime, përkatësisht me KRAT - Elbasan, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Durrës, Fier, Berat, Korçë, Kukës, Gjirokastrë, Dibër dhe Vlorë. Në këto trajnime morën pjesë dhe u trajnuan 300 persona (anëtarë të tryezave teknike të KRAT-ve dhe aktorë të tjerë vendorë duke përfshirë edhe shoqërinë civile).

Një komponent i rëndësishëm i këtyre trajnimeve ishte edhe promovimi i Strategjisë së re Antitrafik 2008-2010, duke u fokusuar kryesisht në vizionin e kësaj Strategjie për funksionimin e KRAT-ve (detyrat, angazhimet dhe përgjegjësitë).

Këto trajnime kanë shërbyer edhe për ndërgjegjësimin dhe sensibilizimin e strukturave vendore në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Një objektivi tjetër i rëndësishëm i këtyre trajnimeve, ka qenë edhe rritja e

bashkëpunimit dhe kapaciteteve të KRAT-ve dhe strukturave vendore nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të një rrjeti komunikimi në nivel vendor.

Trajnimet e zhvilluara sipas datave:

- 11 dhjetor 2008 – Komiteti Rajonal Antitrafik Elbasan (30 pjesëmarrës)
- 28 janar 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Lezhë (20 pjesëmarrës)
- 3 shkurt 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Shkodër (20 pjesëmarrës)
- 6 shkurt 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Durrës (30 pjesëmarrës)
- 12 shkurt 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Tiranë (29 pjesëmarrës)
- 19 shkurt 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Fier (26 pjesëmarrës)
- 26 shkurt 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Berat (25 pjesëmarrës)
- 3 mars 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Korçë (25 pjesëmarrës)
- 24 mars 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Kukës (24 pjesëmarrës)
- 3 prill 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Gjirokastrë (25 pjesëmarrës)
- 24 prill 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Dibër (25 pjesëmarrës)
- 30 prill 2009 – Komiteti Rajonal Antitrafik Vlorë (15 pjesëmarrës)

### ***1.1. Autoriteti Përgjegjës***

Autoriteti Përgjegjës është struktura që bashkërendon identifikimin, kthimin, pritjen, referimin për ndihmë dhe ri-integrimin e viktimave dhe/ose viktimave të mundshme të trafikimit. Autoriteti Përgjegjës ka për detyrë të bashkëpunojë me të gjitha strukturat, në Shqipëri dhe jashtë saj, për identifikimin e viktimave, si dhe të sigurojë që të gjitha shërbimet e dhëna ndaj viktimës të kenë në vëmendje respektimin e të drejtave të viktimës dhe të marrin parasysh interesin më të lartë të saj. Autoriteti Përgjegjës ka përgjegjësi të regjistrojë dhe të raportojë periodikisht të dhënat për rastet e referuara të trafikimit.

Ky Autoritet është mbledhur në mënyrë periodike, si dhe sipas rasteve, për koordinimin e punës mbi asistimin e viktimave të trafikimit, përfshi këtu edhe rastet e fëmijëve që shfrytëzohen në rrugë, si dhe raste transnacionale, ku është vënë kontakt nga dhe me strukturat homologe.

Me gjithë punën e bërë deri tani, ka ende vend për të përmirësuar efektivitetin e Autoritetit Përgjegjës. Në të ardhmen duhet të bëhen përpjekje që anëtarët e këtij Autoriteti të bashkërendojnë punën e tyre më mirë, si dhe të konsiderojnë këtë funksion jo si pjesë të zakonshme të punës së tyre, por si një përgjegjësi të veçantë, e cila kërkon më shumë vëmendje, vullnet dhe veprim të përbashkët. Përbërja e grupit të Autoritetit Përgjegjës me përfaqësues nga strukturat e policisë, të shërbimit social, si dhe të drejtorisë konsullore, është bërë me qëllimin që vendimet e marra lidhur me rastet e ndjekura nga Autoriteti Përgjegjës të marrin një zgjidhje shumëdisiplinore. Për këtë



arsye është e rëndësishme që puna e anëtarëve të këtij Autoriteti të jetë e bashkërenduar në grup. Kjo do të mundësojë një analizë të plotë vlerësuese të nevojave dhe të situatës së viktimës. Gjithashtu, është mjaft e rëndësishme që Autoriteti Përgjegjës të informojë dhe të bashkëpunojë ngushtësisht me Komitetet Rajonale Antitrafik për rastet që ai ndjek.

## **2. Identifikimi i të gjithë personave të trafikuar dhe referimi i tyre i menjëhershëm tek shërbimet e ndihmës; identifikimi i të gjitha formave të shfrytëzimit**

### ***2.1. Baza e të Dhënave për Viktimat e Trafikimit***

Në shtator të vitit 2008, u vu në funksionim Baza e të Dhënave për Viktimat e Trafikimit, e cila administrohet nga Autoriteti Përgjegjës. Në tabelën e përbashkët të raportimit përfshihen 4 rubrika: (1) gjeneralitetet e detajuara, (2) mënyra e identifikimit, (3) historiku i shfrytëzimit, (4) trajtimi në Qendër. Baza e të dhënave për viktimat e trafikimit mundëson përpunimin e të dhënave të sakta rreth trafikimit të qenieve njerëzore, me të dhëna nga policia, shërbimi social shtetëror, qendrat ku ato marrin shërbime, si edhe drejtorja konsullore. Ajo është e integruar në sistemin TIMS<sup>6</sup> dhe është burimi zyrtar statistikor për personat e trafikuar në Shqipëri.

Aktualisht, TIMS është instaluar në 8 Drejtori Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, 3 komisarate të Policisë së Kufirit dhe Migracionit (PKM), 18 Pika të Kalimit Kufitar (PKK) dhe 2 stacione të Policisë Kufitare dhe Migracionit (PKM), ku bëhen intervistimet. Të gjitha PKK-ët që janë miratuar për kthimin e shtetasve janë të pajisura me TIMS dhe 9 prej tyre me Live Scanner (për marrjen e shenjave të gishtërinjve). Personat që kapen në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit, regjistrohen në sistem në Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit.

Në këtë mënyrë, duke qenë e integruar në Sistemin TIMS, Baza e të Dhënave bën të mundur ndjekjen e rasteve, që nga faza e identifikimit deri në fazën e fundit, atë të rehabilitimit, gjë që mundëson dhe vlerësimin e ecurisë së rastit. Baza e të dhënave ndihmon përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Punëve të Jashtme (pjesëtarë të Autoritetit Përgjegjës), si dhe Qendrave të Mbrojtjes së Viktimave të Trafikimit në regjistrimin e informacionit mbi rastet e viktimave të kthyera, të referuara, të trajtuara dhe të mbrojtura në Shqipëri. Baza e të dhënave plotësohet në mënyrë periodike me të dhëna për rastet e viktimave të trafikimit, që akomodohen në Qendrën Kombëtare për Pritjen e Viktimave të Trafikimit, Qendrën "Të ndryshëm dhe të barabartë, Qendrën "Vatra", Qendrën "Tjetër Vizion" dhe Qendrën "Jetë dhe Shpresë".

<sup>6</sup> Total Information Management System

Baza e të Dhënave mundëson analizimin e informacionit duke krijuar një tablo të qartë të situatës së trafikimit në vend, si dhe evidentimin në kohë të tendencave të trafikimit të personave në Shqipëri për t'i dhënë një përgjigje të shpejtë dhe efektive trafikimit të personave.

Tashmë, janë përcaktuar procedurat e hedhjes së të dhënave, janë caktuar personat/operatorët përkatës, afatet kohore për hedhjen e të dhënave, dhe të dhënat nga agjensitë e lartpërmendura hidhen çdo muaj.

Gjatë përdorimit të Bazës së të Dhënave që nga koha e vënies së saj në përdorim të plotë, janë vënë re disa vështirësi dhe mangësi. Është e nevojshme që këto mangësi teknike të zgjidhen sa më parë për të shmangur çdo lloj paqartësie në paraqitjen e statistikave zyrtare.

### *Statistika nga Baza e të Dhënave për Viktimat e Trafikimit*

Numri i viktimave të identifikuara gjatë periudhës Janar 2008 – qershor 2009 është si më poshtë:

	Grup-mosha	Nr. i identifikimeve
1.	Fëmijë	17
2.	Femra	78
3.	Romë	3
5.	Të tjerë	12
6.	<b>Totali</b>	<b>110</b>

Në tabelën e mësipërme, vërehet qartë se edhe gjatë kësaj periudhe raportimi, kategoria më e prekur janë femrat, duke përbërë kështu numrin më të madh të rasteve të trafikimit.

Numri i referimeve sipas agjensive referuese:

	Agjensia Referuese	Nr. i referimeve
1.	Policia	54
3.	Qendrat	8
4.	Të tjerë <sup>7</sup>	48
6.	<b>Totali</b>	<b>110</b>

Siç vihet re dhe nga tabela e mësipërme, për vitin 2008 dhe 6-mujorin e parë të 2009-ës, Policia e Shtetit ka qenë referuesi parësor i rasteve të identifikuara të trafikimit tek

<sup>7</sup> Viktima të referuara nga agjensi të tjera, ose viktima të vetë-identifikuara

qendrat. Qendrat kanë bashkëpunuar ngushtësisht me Sesionet Antitrafik në Drejtoritë e Policisë në rrethet Tiranë, Elbasan, Durrës, Kukës, Korçë, Berat, Lezhë, dhe falë ndihmës që ato i kanë ofruar këtyre Sesioneve është mundësuar edhe identifikimi i viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit.

*Numri i viktimave të asistuara në qendra:*

	Qendra	Fëmijë	Femra	Romë	Të tjerë	Totali
1.	QKPVT	9	9	1		19
2.	Vatra	2	18		2	22
3.	Jetë dhe Shpresë	1	12	1		14
4.	Të Ndryshëm dhe të Barabartë		3			3
5.	Tjetër Vizion		4			4
6.	Të tjera <sup>8</sup>	5	32	1	10	48
7.	Totali	17	78	3	12	110

Pesë qendrat që janë anëtare të MKR-së (QKPVT, Vatra, Jetë dhe Shpresë, Të Ndryshëm dhe të Barabartë dhe Tjetër Vizion) vazhdojnë të jenë qendrat që kanë akomoduar dhe asistuar numrin më të madh të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Ndihma dhe kontributi që ato kanë dhënë në drejtim të mbrojtjes dhe asistimit të këtyre personave është mjaft e madhe dhe vlerësohet plotësisht nga strukturat shtetërore.

## **2.2. Identifikimi i trafikimit të brendshëm**

Trafikimi i brendshëm, nisur nga vlerësimet e bëra si nga ekspertë të huaj dhe vendas, tashmë është një çështje të cilës i kushtohet vëmendje në rritje. Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e këtij fenomeni, mendohet të jenë forcimi i kontrollit të kufijve, rritja e bashkëpunimit në fushën penale ndërmjet autoriteteve përgjegjëse shqiptare dhe atyre të vendeve kryesore të destinacionit, politika shtrënguese e vendeve të Bashkimit Evropian për menaxhimin e migracionit të paligjshëm, etj.

Në këtë drejtim, është parë e nevojshme që të përmirësohen standardet e identifikimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të brendshëm. Për këtë arsye, është gjykuar i rëndësishëm miratimi me akt ligjor i udhëzuesit për procedurat standarde operative. Në këtë mënyrë do të institucionalizohen marrëdhëniet ndërmjet instancave shtetërore, të përfshira në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore në nivel qendror dhe vendor, si dhe ofruesve të shërbimeve në Shqipëri, duke marrë trajtën e një dokumenti zyrtar, të detyrueshëm për zbatim, si dhe shumëdimensional në mbulimin e imtësishëm të fenomenit të trafikimit në Shqipëri.

<sup>8</sup> Viktima të asistuara në shtëpi, të asistuara nga të tjera OJF-ë, etj.

Ky instrument është një nevojë për t'i dhënë përgjigjen e duhur këtij fenomeni, duke përfshirë të gjitha proceset që kalon një viktimë e trafikimit që nga identifikimi dhe deri tek procedimet penale, duke orientuar dhe koordinuar veprimet dhe aktivitetet e secilës instancë shtetërore, të përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave. Ky dokument, do t'iu vijë në ndihmë atyre punonjësve, të cilët punojnë nga afër me viktimat, duke iu treguar në mënyrë kronologjike se cila strukturë përfshihet në cilën etapë.

Po në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe Komitetet Rajonale Antitrafik. Gjatë periudhës në fjalë, është vënë re një angazhim më serioz i këtyre strukturave në identifikimin e rasteve të trafikimit në rajonet përkatëse të vendit ku ato janë ngritur. Përmirësimi i punës së këtyre Komiteteve vjen dhe si rezultat i një bashkëpunimi më të ngushtë jo vetëm ndërmjet strukturave vendore që përfaqësohen në këto Komitete, por edhe me vetë komunitetin dhe OJF-të që veprojnë në rajonin e tyre.

### ***2.3. Identifikimi i rasteve në Pikat e Kalimit Kufitar***

Për sa i përket rritjes së numrit të rasteve të identifikuara në pikat e kalimit kufitar, ka filluar tashmë puna për hartimin e Procedurave Standarde Operative (PSO) vendore për identifikimin fillestar në kufi të personave të trafikuar. Deri tani janë hartuar 3 procedura vendore, përkatësisht në Rinas, Kapshticë dhe Kakavije. Policia e Kufirit dhe Migracionit është duke vazhduar punën për hartimin e tyre edhe në PKK-të e tjera.

Gjatë periudhës 09/'08 – 06/'09 janë identifikuar nga PKM 6 viktima të mundshme trafikimi. Gjatë vitit 2008 nga intervistimi i të kthyerve janë identifikuar 23 viktima të mundshme trafikimi; 6 nga intervistimi në dalje ose në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit dhe pjesa tjetër nga të kthyerit (deportivët).

Duke marrë në konsideratë faktin se në të shumtën e rasteve, personat e identifikuar si viktima/viktima të mundshme të trafikimit janë femra, është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme që intervistimi i tyre në kufi të kryhet nga punonjëse policie femra të trajnuara për intervistimin dhe identifikimin e personave të trafikuar.

Aktualisht, në strukturat antitrafik në shkallë republike janë të emëruara 17 punonjëse policie femra, të cilat janë trajnuar në lidhje me teknikat e intervistimit dhe identifikimin e viktimave të trafikimit sipas Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Trajnimet janë organizuar nga Sektori kundër Trafiqueve të Paligjshme në Policinë e Shtetit në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar dhe ICITAP.

Gjithashtu, është siguruar prania e një punonjësi social, nga Drejtoria Rajonale e Shërbimi Social Shtetëror ose ofruet shërbimi, për të asistuar gjatë fazës së kryerjes së intervistës fillestare të identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit në 10 prej pikave më të prekura kufitare.

Për të rritur kapacitetet e personave që kryejnë identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit, gjatë vitit 2008 e në vazhdim me mbështetjen e donatorëve të huaj janë kryer disa trajnime si:

- Trajnime për njohjen e Procedurave Standarde Operative të Referimit Kombëtar dhe Transnacional të Viktimave të Trafikimit, me target aktorët kryesorë për zbatimin e procedurave, përkatësisht punonjësit socialë të zyrave rajonale, punonjësit e policisë kufitare dhe të migracionit, etj. Këto trajnime janë organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe me mbështetjen e ICMPD-së;
- 11 trajnime me punonjësit socialë të zyrave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) dhe ofruesve të shërbimit të VeT në bashkëpunim me OSBE-në.
- cikle trajnimesh për stafet e Qendrave të Pritjes dhe Riintegritimit të VeT, për punonjësit socialë të zyrave rajonale të SHSSH, personat e angazhuar në Komitetet Rajonale Antitrafik, stafet e OJF-ve, që punojnë në fushën e antitrafikimit dhe specialistë të policisë kufitare dhe migracionit të përfshirë në identifikimin fillestar të VeT, në bashkëpunim me IOM.
- në muajt shkurt-prill 2009, në 12 rajonet e vendit u zhvilluan trajnime për ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve në nivel lokal mbi çështjet e trafikimit, organizuar nga OSBE në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe zbatuar nga Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim. Pjesëmarrësit në trajnim ishin përfaqësues të të gjitha drejtorive rajonale që janë të përfshira në Komitetet Rajonale Antitrafik si: policia, drejtoritë rajonale të shërbimit social, të punësimit, arsimit, shëndetit publik, SHISH, si dhe OJF. Pjesëmarrësit u njohën me përmasat, format dhe shkaqet e lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore, me Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010, me kornizën institucionale dhe ligjore, me përbërësit e procesit të identifikimit, parimet ku duhet mbështetur intervistimi, me mekanizmat e referimit, me hapat që duhet të ndiqen për referimin e një viktime trafikimi, me ndjekjen dhe monitorimin e rastit. Ky trajnim do të japë një impakt pozitiv në punën e Komiteteve Rajonale Antitrafik.

#### ***2.4. Nxitja e vetë-identifikimit;***

Inkurajimi i viktimave të trafikimit për të bashkëpunuar me policinë dhe prokurorinë në hetimin e rasteve të trafikimit; rritja e ndërgjegjësimit mbi trafikimin e personave, si dhe informimi për shërbimet e vlefshme për personat e trafikuar dhe mënyrat se si ato mund të përftohën.

Gjatë vitit 2008, Sektori i Luftës kundër Trafikeve të Paligjshme në Policinë e Shtetit ka bashkëpunuar me 24 viktima të trafikimit në hetimin e rasteve të trafikimit të

personave. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, ky sektor ka regjistruar 24 raste trafikimi, të cilat janë ende nën hetim.

Gjithashtu, vazhdon të jetë në dispozicion të qytetarëve Linja Kombëtare Telefonike (08001212) falas për antitrafikim dhe Linja Telefonike për Dhunën në Familje. Viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës mund të telefonojnë falas në këto linja, në çdo orë të ditës. Në rastet e dhunës në familje, viktimat e dhunës në familje, mund të telefonojnë edhe organizatat jofitimprurëse, që japin ndihmë për këtë kategori, që janë të licensuara nga MPCSSHB. Këto organizata kanë përgatitur dhe fletëpalosjet përkatëse për ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi dhunën në marrëdhëniet familjare.

Organizatat Jofitimprurëse, të cilat ofrojnë shërbime për këtë kategori në të gjithë vendin janë:

- Shoqata “Refleksione”, Tiranë, tel: (04) 23 404 33/4;
- Qendra e Këshillimit për gra dhe vajza, Tiranë, tel: (04) 2233408;
- Qendra për nisma ligjore qytetare, Tiranë, tel: (04) 224 1914;
- Qendra e të drejtave të njeriut në demokraci, Tiranë, tel: (04) 2230084;
- Qendra sociale për gra dhe vajza, Durrës, tel: (052) 23460;
- Forumi i gruas Elbasan, Elbasan, tel: (054) 255509;
- Gruaja te gruaja, Shkodër, tel: (022) 241154;
- Qendra e Gruas “Hapat e lehtë”, Shkodër, tel: (022) 244 022;
- “The Door”, Shkodër, tel: (022) 243729;
- Qendra e Këshillimit dhe e Shërbimeve Sociale Kukës, tel: (024) 22 4278;
- Qendra e grave “Kristal”, Berat, Tel. (032) 23 1004;
- Ndihmë sociale gruas kryefamiljare, Kuçovë, cel: 069 22 96 445;
- Gruaja korçare, Korçë, tel: (082) 2435 63;
- Shoqata “Unë gruaja”, Pogradec, tel: (083)222140

Gjithashtu, me mbështetjen e donatorëve dhe shoqatave janë përgatitur materiale informuese mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Një prej tyre është edhe ‘Doracaku’ i ofruesve të shërbimeve për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, i cili është hartuar me përkrahjen e OSBE-së dhe Aleancës Gjimore për Zhvillim. Në këtë ‘Doracak’ jepet një informacion i detajuar për trajtimin gjithëpërfshirës të fenomenit të trafikimit të personave. Temat që trajton ‘Doracaku’ kanë të bëjnë me kornizën ligjore dhe institucionale për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, identifikimin dhe referimin e personave të trafikuar, mbrojtjen dhe riintegrimin e tyre, trajtimin e viktimës dhe kujdesin e ofruesit të shërbimeve, si dhe parandalimin e fenomenit. Një tjetër risi e ‘Doracakut’ është përfshirja e Standardeve për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në Qendrat Rezidenciale, të cilat janë hartuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Për sa i përket rritjes së ndërgjegjësimit të strukturave që ofrojnë shërbime për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi, si dhe ofrimit të informacioneve të nevojshme për shërbimet në dispozicion të këtyre personave dhe mënyrat se si kjo kategori mund të përfitojë nga këto shërbime, nga ana e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta po merren masat përkatëse. Në këtë drejtim kjo Ministri, ka marrë hapa konkrete për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore për ngritjen e shërbimeve të reja sociale mbi bazën e vlerësimeve të bëra. Aktualisht, është ngritur një strukturë pranë SHSSH-së për rritjen e kapaciteteve të OJF-ve, njësite vendore dhe profesionistëve të angazhuar në ofrimin e shërbimeve.

Pranë Shërbimit Social Shtetëror është ngritur **Drejtoria e Trajnimit dhe Projekteve**. Kjo Drejtori bashkëpunon me organizatat joqeveritare, donatorët dhe institucionet që kanë ofruar projekte dhe programe për fuqizimin e shërbimeve dhe strukturave të shërbimit social.

Në mbështetje të objektivave të SHSSH për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe rritjes së performancës së strukturave të angazhuara në menaxhimin, administrimin dhe inspektimin e shërbimeve sociale, është hartuar programi i Trajnimit për vitin 2009. Programi i trajnimit është fokusuar në përmirësimin e aftësive profesionale rreth çështjeve të tilla thelbësore sikurse janë implementimi i standardeve të shërbimeve sociale, aplikimi i metodologjisë së re të inspektimit të shërbimeve sociale, decentralizimi dhe kompetencat e strukturave të pushtetit vendor në ofrimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, deinstitutionalizimi dhe përmirësimi i punës sociale në institucionet e përkujdesit shoqëror etj. Janë vendosur kontakte bashkëpunuese me institucione dhe donatorë të ndryshëm, me synimin e mbështetjes teknike dhe financiare të Programit të Trajnimit të miratuar nga Këshilli Administrativ pranë SHSSH. Në këtë kontekst, përmendim vendosjen e bashkëpunimit me ITAP, IOM, UNICEF, UNFPA, PNUD, IFC.

- Në bashkëpunim me IOM është hartuar axhenda e trajnimit të punonjësve social të Zyrave Rajonale të SHSSH të cilët do të angazhohen në identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit në pikat kufitare;
- Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Terre des Hommes, punonjësit e SHSSH-së janë përfshirë në "Workshopin për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve që u zhvillua në Tiranë gjatë muajit Qershor;
- Gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa trajnime të përfaqësuesve të minoritetit rom në bashkëpunim me ICF. Trajnimet janë zhvilluar në disa rrethe të vendit si në Tiranë, Korçë, Vlorë, Pogradec, Elbasan, Fier, Durrës dhe Lezhë.

Realizimi i programit të trajnimit është bazuar në një strategji gjithëpërfshirëse, duke synuar pjesëmarrjen e stafeve të strukturave publike dhe jopublike, në nivel rajonal dhe

lokal, të specialisteve me eksperiencë dhe të specialisteve të rinj të përfshirë në strukturat e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror.

### **3. Për fëmijët**

#### ***3.1. Ngritja e Linjës Kombëtare Telefonike për Fëmijë në Shqipëri:***

Linja Kombëtare për Fëmijët në Shqipëri është një iniciativë e përbashkët e UNICEF-it dhe Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri/Mbrojtja Ndërkombëtare e Fëmijëve (CRCA/DCI Shqipëri). Linja Kombëtare është përgjegjëse për dhënien e shërbimeve në tre numra telefoni: 116000, 116111 dhe 116123, për të gjithë fëmijët, që ndodhen në Shqipëri, pavarësisht nga kombësia e tyre. Kjo linjë është në dispozicion jo vetëm të fëmijëve shqiptarë, por edhe atyre evropianë kur ata ndodhen në Shqipëri. Linja Kombëtare për Fëmijë, ka filluar të funksionojë në fillim të vitit 2009. Personat, të cilët operojnë këtë linjë telefonike i përgjigjen telefonatave të fëmijëve nga e gjithë Shqipëria në mënyrë të kualifikuar dhe profesionale, 24 orë në ditë, gjatë 7 ditëve të javës.

Kjo linjë është në dispozicion të më shumë se 1 milionë fëmijëve në të gjithë Shqipërinë, 24 orë gjatë 7 ditëve të javës, pa pagesë dhe e mundur për t'u aksesuar si nga numrat fiks edhe nga ata celularë.

#### **4. Ofrimi i ndihmës dhe mbrojtjes gjithëpërfshirëse sociale për të gjithë personat e trafikuar, në përputhje me nevojat individuale dhe pavarësisht nga vullneti i tyre për të bashkëpunuar me autoritetet dhe nxitja e rehabilitimit dhe përfshirjes sociale të personave të trafikuar**

Standardet për Viktimat e Trafikimit, të miratuara në vitin 2007 me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 195, dt. 11.4.2007 kanë të përcaktuar detyrimin e institucioneve për informimin e personave të trafikuar mbi të drejtat e tyre dhe për mënyrën se si kjo kategori personash mund t'i ushtrojë këto të drejta. Ofruesi i shërbimit ofron informacion të vazhdueshëm mbi të drejtat e përfituesve dhe afishon forma të shkruara të të drejtave të përfituesve të shërbimeve, si dhe sigurohet që nëpërmjet diskutimeve përfituesit t'i kuptojnë dhe t'i gëzojnë të drejtat e tyre.

Ofruesit publikë dhe privatë të shërbime zbatojnë Standardet për Viktimat e Trafikimit në qendrat rezidenciale. Me mbështetjen e UNICEF-it është hartuar edhe draft-Udhëzuesi për zbatimin e standardeve kombëtare të përkujdesjes sociale për personat e trafikuar ose personat në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale. Drafti po pilotohet nga qendrat që ofrojnë shërbime.



Draft-Udhëzuesi është hartuar për të ndihmuar ofruesit e shërbimeve sociale të plotësojnë Standardet Kombëtare të Shërbimeve për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në Qendrat Rezidenciale në Shqipëri. Këto udhëzime dhe formularë kanë si synim të ndihmojnë ofruesit e shërbimeve rezidenciale në zbatimin me efektivitet të standardeve, në promovimin e referimeve nëpërmjet përdorimit të formularëve dhe procedurave të unifikuara, dhe t'ju bëjë të qartë ofruesve të shërbimeve rezidenciale dhe inspektorëve indikatorët, që duhet të përdoren nga inspektorët për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e standardeve nga qendrat e licensuara.

Gjatë kohës së zbatimit ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve do të mbështeten me trajnime për stafet e tyre, për të kuptuar dhe zbatuar më mirë udhëzuesin.

Drejtoria e inspektimit të shërbimeve ka realizuar 13 inspektime me qëllim monitorimin e zbatimit të standardeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e trafikimit për të siguruar dhe matur cilësinë e shërbimeve në interes të përfituesve. Po kështu inspektorët e sektorit të të rriturve në drejtorinë e inspektimit të standardeve kanë qenë të angazhuar në hartimin e Draft - udhëzuesit për zbatimin e standardeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e trafikimit.

#### ***4.1. Qendrat Pritëse për Viktimat e Trafikimit***

MPÇSSHB prej gjashtë vjetësh ka ngritur Qendrën Pritëse të Viktimave të Trafikimit në Tiranë dhe ka financuar rregullisht funksionimin e saj në ndihmë të pritjes dhe riintegrimin të viktimave të trafikimit, vendase dhe të huaja. Çdo vit, Qendra financohet nga buxheti i shtetit me 18 milion lekë. Në Qendër janë punësuar 23 persona të kualifikuar, të cilët ofrojnë shërbime specifike për akomodimin, rehabilitimin dhe integrimin e viktimave. Qendra ka një kapacitet prej 100 vendesh. Për vitin 2008 janë programuar 24,5 milion Lekë ose rreth 34% më shumë se në vitin 2007. Për vitin 2009 janë programuar 26,2 Milion Lekë. Pra, në krahasim me vitin 2008 ka një rritje prej 6.5%.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Anti-trafikimin në Njerëz dhe me aktorë të tjerë kanë përgatitur projektligjin "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9355 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar në të cilin përfshihet mbështetja e viktimave të trafikimit me ndihmë ekonomike pas trajtimit në qendrat, që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit.

Në një nen të veçantë parashikohet mbështetja me fonde buxhetore për 4 qendrat jopublike që ofrojnë shërbime për këtë kategori. Për disbursimin e fondeve do të bashkëpunohet me njësitë vendore në kuadër të reformës së shërbimeve për decentralizimin e shërbimeve.

Për këtë nisëm ligjore krahas studimit të bëra janë zhvilluar edhe disa takime ndërmjet aktorëve të ndryshëm dhe me grupet e interesit. Këtu do të veçonim takimin e organizuar nga ZKKA me shoqatat që ofrojnë këtë shërbim. Projektligji është dërguar në Këshillin e Ministrave për miratim.

#### **4.2. Ngritja e qendrave të reja shërbimesh komunitare për fëmijë:**

Në vitin 2008 janë ngritur dhe funksionojnë 43 shërbime komunitare me mbështetjen e projektit të Bankës Botërore. Shërbimet shtrihen në 8-qarqe dhe në 2-bashki/komuna. Janë kryer punime në 43-qendra të shërbimeve komunitare dhe janë marrë në dorëzim nga pushteti vendor. Në këto qendra ofrohen shërbime ditore nga OJF për fëmijët, të rinjtë, PAK, gra dhe vajza të trafikuar. Janë rikonstruktuar dhe pajisur 5 qendra shërbimesh rezidenciale në përputhje me kërkesat e reja të standardeve të shërbimeve.

Qendrat e shërbimeve janë pajisur me orenditë e nevojshme dhe pajisje të tjera për plotësimin e kushteve të jetesës në përputhje me standardet e reja të shërbimeve. Shërbimet mbështeten me fonde, ekspertizë dhe monitorohet performanca e tyre.

Legjislacioni garanton ngritjen e shërbimeve të reja komunitare, krahas shërbimeve ekzistuese të përkujdesit rezidencial dhe zgjerimin e llojshmërisë dhe gjeografisë së tyre në të gjithë vendin. Është rritur pjesëmarrja e njësive të qeverisjes vendore dhe organizatave të shoqërisë civile për programimin dhe realizimin e shërbimeve shoqërore. Gjithashtu, po zbatohen dhe monitorohen standardet e shërbimeve për fëmijët. Po në këtë drejtim, po merren masat për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore për ngritjen e shërbimeve të reja sociale. Është ngritur një strukturë pranë SHSSH<sup>9</sup>-së për rritjen e kapaciteteve të OJF-ve, njësive vendore dhe profesionistëve të angazhuar në ofrimin e shërbimeve.

#### ***Shërbimet komunitare të ngritura sipas qarqeve***

Në tabelën e mëposhtme do të gjeni një informacion të përmbledhur mbi numrin e shërbimeve komunitare<sup>10</sup> ditore dhe rezidenciale të ngritura sipas qarqeve. Këto shërbime janë ngritur me qëllim mbrojtjen e grupeve në nevojë siç janë fëmijët, pleqtë, romët, të rinjtë, gratë dhe vajzat përfshirë edhe viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit.

Nr.	Qarku	Faza e parë	Faza e dytë	Total
1	Shkodër	5	3	8
2	Lezhë	-	2	2

<sup>9</sup> Shërbimi Social Shtetëror

<sup>10</sup> Informacion më të plotë për llojet e shërbimeve të ngritura do të gjeni në fund të këtij raporti tek Aneksi 2.

3	Bashkia Tiranë	3	4	7
4	Qarku Tiranë	3	2	5
5	Durrës	1	4	5
6	Fier	-	2	2
7	Vlorë	4	3	7
8	Gjirokastër	-	3	3
9	Elbasan	-	1	1
10	Bashkia Poliçan	-	1	1
11	Bashkia Berat	-	1	1
12	Bashkia Kukës	-	1	1

Impakti i shërbimeve të ngritura:

- Numri i përfituesve të drejtpërdrejtë nga këto shërbime është 25.400, nga të cilët 11000 janë fëmijë ( nga 0 deri 18-vjeç);
- Numri i përfituesve indirekt në shërbimet komunitare vlerësohet të jetë përafërsisht 2 deri në 3 herë më i lartë;
- Në këto qendra përmirësohet cilësia e shërbimeve për 25.400 persona;
- Kostoja ditore e shërbimit për një klient vlerësohet të jetë përafërsisht 50 % më e ulët se kostoja e një klienti në shërbimet rezidenciale;
- Njësitë vendore garantojnë vazhdimësinë e tyre;
- OJF-të ofrojnë shërbimet e ngritura dhe përfshihen në procesin e vlerësimit të nevojave;
- Për garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka hartuar një udhëzim, ku garantohej mbështetja e politikave të reja dhe zhvillimi i shërbimeve komunitare;
- Libri i Legjislacionit është dërguar në njësitë vendore dhe tek aktorët e tjerë.

Shërbimet mbështeten me fonde, ekspertizë dhe performanca monitorohet nga institucioni qendror përgjegjës. Një mekanizëm i ri garanton qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve me fondet e buxhetit qendror dhe lokal.

#### **4.3. Trajnimet e organizuara me stafin konsullor në përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit:**

Në Qershor 2008, Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me IOM dhe Akademinë Diplomatike organizoi sesione trajnimi me shtatë konsuj në misionet tona diplomatike jashtë vendit. Vendet ku u zhvilluan këto trajnime ishin:

- Italia

- Greqia
- Britania e Madhe
- Gjermania
- Kanadaja
- Shtetet e Bashkuara të Amerikës
- Belgjika

Gjatë vitit 2008, konsullatat tona jashtë kanë asistuar një numër të konsiderueshëm emigrantësh të parregullt. Ndihma e tyre ka konsistuar në pajisjen e këtyre personave me dokumentacionin e rregullt për të udhëtuar, si dhe kanë lehtësuar kthimin e tyre të sigurt në Shqipëri.

## **5. Sigurimi i mbrojtjes së veçantë për viktimat, të cilat paraqiten si dëshmitarë në procedimet penale**

Gjatë periudhës në fjalë, janë zbatuar masat e posaçme të mbrojtjes për një numër rastesh me një numër të konsiderueshëm personash, të cilët klasifikohen dëshmitarë të drejtësisë, bashkëpunëtorë të drejtësisë, persona të afërm apo të lidhur me ta, por ndër personat e marrë në mbrojtje nuk ka patur dhe nuk ka asnjë person, viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo pasi nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm nuk ka patur propozime për marrjen në mbrojtje të viktimave të trafikimit, dëshmitarë, si dhe nuk rezultojnë të ketë patur as edhe një rast të sinjalizuar të rrezikut. Gjithsesi, duhet theksuar se Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve plotëson kushtet, ka mundësitë dhe ndihmën e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e viktimave\ dëshmitarë.

Për sa i përket përmirësimit të kuadrit ligjor në këtë fushë, është hartuar tashmë drafti i projektligjit “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”, i cili ka kaluar në Këshillin e Ministrave në muajin qershor 2009. Tashmë janë duke u ndjekur procedurat e mëtejshme për miratimin e tij në Parlament.

Gjithashtu, janë nënshkruar edhe dy marrëveshje ndërkombëtare, njëra në vitin 2008 dhe tjetra në vitin 2009, me objekt ndryshimin e vendbanimit të personave të marrë në mbrojtje nga territori i Republikës së Shqipërisë në territorin e shteteve nënshkruese të marrëveshjeve.

### **5.1. Investime dhe programe**

Ekzistojnë standardet e mbrojtjes, modelet dhe planet e mbrojtjes individuale për dëshmitarët dhe/ose bashkëpunëtorët e drejtësisë. Gjithashtu, masat e sigurisë zbatohen *non stop*, 24 orë në ditë, por monitorimi i tyre nuk mund të ushtrohet nga asnjë strukturë apo institucion tjetër përveç strukturës së mbrojtjes së dëshmitarëve.

Në lidhje me pozitën e dëshmitarit në gjyq, në kuadër të përmirësimit të procesit hetimor, në vitin 2008, me fondet e OPDAT-it (45000 USD), është blerë dhe instaluar sistemi i video-konferencës për Gjykatën e Krimeve të Rënda të Shkallës së Parë në Tiranë. Aktualisht kanë përfunduar të gjithë instalimet në këtë gjykatë. Me fondet e dhëna nga Qeveria Amerikane, janë blerë gjithashtu edhe dy sisteme të reja video-konferencash, një për Policinë e Shtetit dhe një për Prokurorinë e Përgjithshme. Aktualisht, është në proces instalimi i video-konferencës në Policinë e Shtetit, dhe vendosja e lidhjes ndërmjet kësaj video-konference me video-konferencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda, në Tiranë, si një mjet i rëndësishëm teknik për zbatimin e masave të posaçme të mbrojtjes. Nëpërmjet tyre do të realizohet në përputhje me rregullat procedurale penale, pyetja e dëshmitarëve në distancë si dhe transformimi i zërit apo pamjes së dëshmitarëve, duke zbatuar kërkesat e procedurës penale dhe akteve ndërkombëtare në këtë fushë, veçanërisht Konventës së Këshillit të Evropës “Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006.

Në kuadër të angazhimit për përmirësimin e imazhit të gjykatave shqiptare dhe rritjen e besueshmërisë ndaj tyre, USAID/ROLP<sup>11</sup> ka bërë prezantimin e projektit të tij për këtë qëllim, i cili përfshin në investimet e tij 10 gjykatat pilot. Për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, i nënshkruar midis Ministrisë së Drejtësisë, KLD-së, Konferencës Kombëtare Gjyqësore, Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, i cili vendos parametrat e asistencës teknike që programi i sipërpërmendur do të ofrojë për 10 gjykatat, janë organizuar takime të Komitetit Këshillimor Teknik të Punës për të mbështetur këtë program, duke diskutuar mbi aktivitetet e parashikuara, zbatimin e tyre dhe përmirësimet në planin e punës.

Investimet në infrastrukturë kanë qenë të shumta dhe sipas raporteve të paraqitura për periudhën nga ROLP, janë instaluar një numër i madh pajisjesh si kompjuterë, monitorë, printerë, ekrane, UPS, Switch, inverter, etj.

Si pjesë e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore, ROLP pajisi të gjithë gjyqtarët e gjykatave pilot me bibliotekën elektronike “Juristi”, i cili i jep mundësinë gjyqtarëve të kenë akses tek ligjet shqiptare, duke mundësuar edhe përditësimin e legjislacionit në fuqi.

Një angazhim tjetër i rëndësishëm i memorandumit të mirëkuptimit, është përmirësimi në arkivimin e dosjeve gjyqësore, i cili sjell një menaxhim më efektiv të dosjeve gjyqësore.

---

<sup>11</sup> Rule of law program – Programi për shtetin e së drejtës

ROLP është duke shqyrtuar kërkesa të tjera përmirësimi në infrastrukturë dhe në sistemin lidhur me përgjigjet ndaj kërkesave të publikut.

## *5.2. Mbrojtja e viktimave të huaja*

Një ndër ndryshimet e rëndësishme ligjore në aspektin e mbrojtjes së viktimave të trafikimit është edhe miratimi i Ligjit të ri nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të Huajt”. Ky ligj është në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për “Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” të nënshkruar në vitin 2006, garanton pajisjen me leje të përkohshme qëndrimi të viktimave të huaja në Shqipëri, të cilat kanë nevojë për mbrojtje të përkohshme për të paktën 3 muaj.

Si risi e këtij ligji është edhe parashikimi i programeve të Integritit Social të të Huajve në jetën dhe shoqërinë shqiptare. Lidhur me pjesën që rregullojnë lejen e qëndrimit, ligji parashikon të rregullojë aspektet kryesore duke përfshirë edhe futjen e koncepteve të reja që kanë të bëjnë me personat që janë subjekt i këtij ligji, autoritetet shtetërore që ushtrojnë kompetenca në fushën për të huajt, trajtimin e të huajve, dokumentet e hyrjes dhe të qëndrimit në Republikën e Shqipërisë, etj. Ky ligj rregullon plotësisht kompetencat e Policisë Kufitare dhe Migracionit për të grumbulluar, ruajtur dhe përpunuar të dhënat personale si dhe mbajtjen e evidencës për mbikëqyrjen e të huajve në përputhje me standardet e BE-së. Në seksionin e lejeve të qëndrimit, përcaktohen afatet e secilës leje dhe ripërtëritja e saj në rast se i mbaron afati i caktuar. Sipas këtij ligji lejet e qëndrimit janë të përkohshme me afat ripërtëritjeje dhe të përhershme, të cilat e shndërrojnë të huajin në rezident të përhershëm me të drejta pothuajse të plota si shtetasit shqiptarë. Aty specifikohen procedurat dhe dokumentacioni për lëshimin e lejeve të qëndrimit, rregullat për t’u pajisur me leje qëndrimi për kategori të veçanta personash përfshirë edhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore.

## *Rekomandime dhe sugjerime*

Duke u nisur edhe nga mangësitë e konstatuara kryesisht nga raportimet e vetë institucioneve zbatuese të Strategjisë Anti-trafik 2008-2010, por edhe nga konstatimet dhe gjetjet e Koordinatorit Kombëtar dhe Njesisë Anti-trafik sugjerojmë që për sa i përket mbrojtjes dhe asistencës së viktimave të trafikimit në të ardhmen përpjekjet e të gjithë aktorëve duhet të fokusohen në këto drejtime kryesore:

- Përmirësimi i punës për sa i përket koordinimit të masave dhe veprimeve ndërmjet institucioneve qëndrore dhe vendore përgjegjëse si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht për mbrojtjen dhe asistencën e personave të trafikuar;
- përmirësimi i standardeve dhe procedurave të identifikimit; identifikimi i rasteve të trafikimit të brendshëm; identifikimi në pikat e kalimit kufitar; nxitja e vetë-identifikimit të personave të trafikuar;

- lehtësimi i kthimit, (ri) integritit dhe përfshirjes sociale të personave të trafikuar dhe reduktimi i rrezikut të ri-viktimizimit e ritrafikimit të personave të trafikuar, si edhe sigurimi i ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat shqiptare jashtë vendit;
- përfshirja e viktimave të trafikimit në programin e veçantë për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- rritja e kapaciteteve nëpërmjet rritjes së burimeve të nevojshme financiare dhe burimeve njerëzore të mirë-trajnuara të shtrira në të gjithë vendin;
- marrja e masave për luftimin e fenomenit të fëmijëve të rrugës, përmirësimi i kuadrit ligjor në këtë drejtim si dhe ngritja e një sistemi efikas që të marrë në mbrojtje këta fëmijë përfshirë edhe shkëputjen nga familja.

## **C. PARANDALIMI**

Të gjitha përpjekjet parandaluese ndaj trafikimit lidhen ngushtë me përpjekjet për zhvillim ekonomik, arsimor, shëndetësor, punësim, lëvizje të lirë, ngritjen e sistemeve të mbrojtjes sociale, ulje të diskriminimit gjinor dhe minoriteteve etj. Gjithashtu një element tjetër i rëndësishëm që lidhet direkt me parandalimin e fenomenit të trafikimit është krijimi i kushteve për shanse të barabarta për grupet e marginalizuara të shoqërisë.

Për të përmbushur këtë qëllim aktivitetet parandaluese të parashikuara në Strategji synojnë rritjen e ndërgjegjësimit të publikut dhe grupeve vulnerabël në veçanti mbi fenomenin, rritjen e mundësive për punësim, rritjen e numrit të fëmijëve të cilët marrin një arsimim cilësor. Për të përmbushur këto objektiva është bërë e mundur rritja e kapaciteteve për agjensitë që ofrojnë ndihmë dhe orientim për punësim, si për ato shtetërore dhe ato private, janë zgjeruar programet që nxisin fëmijët të ndjekin shkollën, janë përmirësuar programet për arsimim profesional, janë rritur përpjekjet për zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere në vend lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, rreziqet e migracionit të parregullt dhe informim mbi rrugët për migracion të rregullt.

Komitetet Rajonale Antitrafik, të ngritura qysh prej vitit 2006 në 12 qarqet e vendit, kanë si detyrë të tyre parësore në fushën e parandalimit identifikimin e grupeve vulnerabël, analizimin e nevojave të tyre dhe hartimin e programeve për adresimin e këtyre problemeve në nivel lokal. Përgjatë këtij kapitulli do të gjeni një informacion mbi aktivitetet parandaluese të Komiteteve Rajonale Antitrafik<sup>12</sup>.

### **1. Ndërgjegjësimi publik**

Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere të vazhdueshme është një mënyrë e mirë për t'u siguruar që publiku, e sidomos grupet vulnerabël, janë të mirë informuar mbi shkaqet dhe pasojat e fenomenit të trafikimit në vend. Gjatë vitit 2008, dhe muajve të parë të vitit 2009, Koordinatorin Kombëtar Antitrafik dhe Njësia Antitrafik kanë mbështetur të gjitha projektet e paraqitura nga aktorë vendas apo të huaj, projekte të cilat ofronin zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuere për publikun. Fushatat kanë synuar grupet në rrezik si dhe aktorët që punojnë me këto grupe, synohet që në të ardhmen gama e këtyre fushatave të zgjerohet edhe për shfrytëzuesit e mundshëm.

---

<sup>12</sup> Informacionet e paraqitura lidhur me aktivitetet e Komiteteve Rajonale bazohen në informacionin e përcjellë nga vetë Komitetet.



Fushatat kanë bërë të mundur që pjesëmarrësit të kuptojnë çfarë është trafikimi i qenieve njerëzore, të jenë të aftë të identifikojnë qëllimet pse trafikohen personat dhe rrugët kryesore nëpërmjet të cilave rekrutohen njerëzit. Pjesëmarrësit gjithashtu kanë marrë informacion mbi realitetet, rreziqet dhe të mirat e migracionit të rregullt. Gjithashtu është synuar që mesazhi të përcjellë promovimin e nismave arsimore dhe të arsimit profesional si alternativë ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit. Gjatë periudhës së raportimit grupi më i shenjëstruar kanë qenë grup-mosha e re, 14-18 vjeç.

Koordinatori Kombëtar dhe Njësia Antitrafik kanë monitoruar nga afër këto fushata ndërgjegjësuere në mënyrë që ato të jenë të mirë-koordinuara dhe të harmonizuara dhe kanë siguruar që mesazhet e përcjella të jenë jo stigmatizuese dhe informacioni i përcjellë të jetë i përditësuar.

Gjatë kësaj periudhe përpjekje të vazhdueshme janë bërë nga Koordinatori Kombëtar Antitrafik dhe Njësia Antitrafik për të inkurajuar autoritetet arsimore për institucionalizimin e temave ndërgjegjësuere mbi trafikimin si pjesë të kurrikulave mësimore, në mënyrë që informacioni që i përcillet të rinjve mbi këtë fenomen të jetë i vazhdueshëm dhe i përditësuar. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë të mundur përfshirjen e temave antitrafik në kurrikulat e lëndëve që trajtojnë temat sociale dhe gjinore. Gjithashtu, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka siguruar që në publikimet speciale për mësuesit, të nxjerrë udhëzime të cilat udhëzojnë mësuesit që ti japin prioritet çështjeve gjinore, trafikimit dhe dhunës në familje gjatë orës së mësimit apo në aktivitete të tjera jashtë shkollore.

## **2. Punësimi**

Fenomeni i trafikimit përmban në vetvete faktorët tërheqës dhe shtytës. Ndër faktorët shtytës të trafikimit përmendëm varfërinë dhe papunësinë, dy elementë të ndërlidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Nëse faktori shtytës është papunësia, faktorët tërheqës janë ofertat për arsimin e punësim, premtimet për martesë të cilat shikohen nga viktima si mundësia e vetme për të dalë nga gjendja e vështirë ekonomike, shitja e fëmijëve nga prindërit/kujdestari, etj. Punësimi është një faktor që lidhet drejtpërdrejt me gjendjen ekonomike në familje, harmoninë familjare dhe mbi të gjitha arsimimin e fëmijëve të familjes.

Institucionet përgjegjëse janë përpjekur të hartojnë politika punësimi pro-aktive, pra jo thjesht dhënie të mbështetjes ekonomike, por krijim të kushteve dhe mundësive për një punësim të plotë dhe në përputhje me aftësitë profesionale të secilit individ të papunë.

Puna e MPÇSSHB lidhur me punësimin është përqendruar në studimin e nevojave të tregut, parashikimin e drejtë të tyre, si dhe ndërmarrjen e të gjitha hapave të nevojshme për t'u përshtatur në kushtet e një tregu pune në zhvillim. si p.sh. Gjatë këtij viti është

rritur fondi për programet e nxitjes së punësimit për kategori të tilla si gratë, të rinjtë dhe kategoritë në nevojë, dhe programe të tilla po zbatohen në të gjithë vendin, veçanërisht në zonën veriore.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) në zbatim të politikave aktive të tregut të punës aplikon katër programe për nxitjen e punësimit, të cilat kanë në fokus grupe specifike të punëkërkuësve të papunë.

Katër programe për nxitjen e punësimit:

- *Për punësimin e punë-kërkuësve femra (VKM Nr.632, datë 18.09.2003)*
- *Për praktikant profesionalë të studentëve (VKM Nr.873, datë 27.12.2006)*
- *Për punëkërkuës të papunë në vështirësi (VKM Nr. 48, datë 16.01.2008)*
- *Nxitje punësimi nëpërmjet formimit në punë (VKM Nr. 47, datë 16.01.2008)*

SHKP kryen çdo vit analizën e situatës së tregut të punës. Kjo analizë shërben si bazë për hartimin e programeve të veçanta të punësimit dhe trajnime për aftësitë profesionale për personat/grupet në nevojë. Për vitin 2008 janë të regjistruara në zyrat e punësimit 18128 vende të lira të punës, ndërsa për periudhën janar – maj 2009 janë të regjistruara në zyrat e punësimit 4323 vende të lira të punës. Nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit në gjithë vendin për vitin 2008 janë aplikuar 157 projekte punësimi, formimi nëpërmjet punës dhe praktikash profesionale. Në bashkëpunim me ILO, CARDS, SIDA, Shërbimi Kombëtar i Punësimit po zbaton projekte, të cilat synojnë fuqizimin e rolit të shërbimeve publike të punësimit në tregun e punës, dizenjimin dhe zbatimin e programeve të reja më fleksibël dhe më aktive.

## **2.1 Zyrat Rajonale të Punësimit**

MPÇSSHB, për të përmirësuar punën e Zyrave Rajonale të Punësimit, po punon për informatizimin e plotë të këtyre Zyrave. Tashmë ka përfunduar informatizimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe zyrat rajonale të punësimit në Tiranë dhe Korçë si dhe synohet që me kontribute të donatoreve dhe buxhetit të shtetit të informatizohet i gjithë sistemi i shërbimeve të punësimit në vend. Nëpërmjet këtij informatizimi do të përmirësohet në mënyrë të ndjeshme cilësia e shërbimeve të ofruara nga zyrat e punësimit dhe do të rritet saktësia e informacionit statistikor të tregut të punës.

Zyrat Rajonale të Punësimit informojnë publikun dhe veçanërisht grupet në nevojë rreth ekzistencës së programeve të punësimit, për programet e nxitjes së punësimit me anë të buletinit zyrtar të njoftimeve si dhe nëpërmjet fletëpalosjeve dhe publikimeve në zyrat e punësimit në çdo qark.

Në zyrat e punësimit janë regjistruar:

**Për vitin 2008:**

**141700** punëkërkues të papunë:

- rreth 22% e tyre (30800) të moshës 15-24 vjeç,
- 74950 ose **53% e tyre me arsim 8 vjeçar.**

**Janë punësuar me ndërmjetësimin e zyrës se punësimit 9550 punëkërkues.**

**Për 6-mujorin e parë të vitit 2009:**

**141245** punëkërkues të papunë

- me moshe deri 24 vjeç, janë gjithsej 29305 punëkërkues të papunë ose 20.7% e totalit;
- me nivel arsimor deri në arsimin 8-vjeçar janë në total 75764 ose 53.6%;
- 9157 punëkërkues të papunë i përkasin grupeve të veçanta (rome, vajza dhe gra të trafikuar, me aftësi të kufizuara, jetime etj.). Nga këto 6588 me arsim 8-vjeçar ose 71% e totalit;
- Numri i përgjithshëm i papunësisë në shkallë vendi është 13%.

**Janë punësuar me ndërmjetësimin e zyrës së punësimit 3265 deri në fund të prillit 2009.**

Gjate vitit 2008 janë regjistruar si punë-kërkuese të papuna pranë zyrave të punësimit, në shkallë vendi 32 femra të trafikuar, të cilat kanë marrë shërbime punësimi si këshillim dhe orientim për punësim e formim profesional, kryesisht në qytetet Elbasan (23), Vlorë, Tiranë dhe Korçë. Ky numër (32) vazhdon të jetë edhe gjatë këtij viti për të pasur shanse punësimi, në përputhje të kërkesë-ofertës.

## ***2.2 Formimi profesional***

Në kushtet e ekonomisë së sotme, tregu i punës kërkon një informim dhe përgatitje të vazhdueshme të individëve për t'iu përshtatur kërkesave të kohës. Arsimi i vazhdueshëm është një element i rëndësishëm për çdo individ punëmarrës në vend, dhe mungesa e formimit profesional është një element i lidhur drejtpërdrejt me papunësinë. Aktivitetet e kësaj strategjie i japin një rëndësi të veçantë aftësimin profesional. Për këtë qëllim po punohet në qendrat e formimit profesional publik, po ashtu ka filluar nga puna edhe Qendra e Formimit Profesional e Lëvizshme e cila do të mbulojë zonën verilindore me kualifikim profesional. Strategjia Kombëtare Antitrafik kërkon që Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të hartoj programe të cilat synojnë në rritjen e mundësive ekonomike për grupet në nevojë ose në rrezik nëpërmjet përpjekjeve të synuara për të mbështetur grupet në nevojë që të kenë mundësi të hyjnë në tregun e punës nëpërmjet punësimit ose veprimtarive të tjera që sjellin të ardhura.

SHKP nëpërmjet Qendrave të Formimit Profesional Publik, në zbatim të politikave aktive të punësimit, ka realizuar programet e formimit profesional për punëkërkuesit e papunë.

**Gjatë vitit 2008 janë certifikuar në kurset e profesioneve: 1857 punëkërkues të papunë, nga të cilët:**

- **586 femra**, 131 prej tyre (me tarifë falas) u përkasin grupeve të veçanta:
  - Romë (18),
  - jetimë (82),
  - **femra të trafikuar (5)**
  - dhe me aftësi të kufizuar (25)

**Gjatë vitit 2009 (4-mujori i pare) janë certifikuar në kurset e profesioneve 657 punëkërkues të papunë, nga të cilët :**

- **258 femra**. 66 prej tyre (me tarifë falas) u përkasin grupeve të veçanta:
  - romë (29);
  - jetimë (16);
  - **femra të trafikuar (19);**
  - dhe me aftësi të kufizuar (2)

### ***2.3 Programet e nxitjes së punësimit***

Ndër politikat sociale aktive, përveç politikave të formimit profesional është *Programi për Nxitjen e Punësimit*. Plani Kombëtar i veprimit synon që të vazhdohen zbatimi i programeve ekzistuese të nxitjes së punësimit dhe të zgjerohet përmbajtja dhe pjesëmarrja e tyre. Gjithashtu për grupe të veçanta në nevojë, ku përfshihen dhe viktimat e trafikimit, duke u bazuar në vlerësimin e nevojave të tyre duhen ngritur programe të veçanta shtesë.

Në programet e nxitjes së punësimit :

Programi punësimi nëpërmjet formimit në punë (VKM nr. 47, datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar):

- Në vitin **2008**, morën pjesë në këtë program **1180 punëkërkues dhe 150 prej tyre janë në vazhdim** edhe gjatë këtij viti.
- Këtë vit (**2009**) marrin pjesë në projektet e reja në zbatim të këtij programi edhe **890 punëkërkues** të tjerë.

Programi punësimi për punëkërkuesit e papunë në vështirësi:

- Në vitin **2008**, nëpërmjet këtij programi **u punësuan 250 punëkërkues të papunë**, të cilët janë në vijim të tij edhe këtë vit.
- Janë punësuar dhe **68 punëkërkues** të tjerë me projektet e reja të çelura këtë vit (**2009**).

Programi për punësimin e punëkërkueseve të papuna femra:

- Në vitin **2008**, nëpërmjet këtij programi **u punësuan 456 punëkërkuese femra**, dhe **407** prej tyre **vazhdojnë** të jenë të punësuara në vijim **edhe këtë vit** (2009).

Programi i praktikave profesionale për studentët që kanë mbaruar arsimin e lartë:

- Ka bërë të mundur punësimin e 302 punëkërkuës të papunë (të diplomuar në dy vitet e fundit) për vitin 2008
- Dhe 324 të tjerë për vitin 2009.

## ***2.4 Agjensitë Private të Punësimit***

Strategjia Kombëtare 2008-2010 kërkon rritjen e kapaciteteve të Agjencive Private të Punësimit për punësimin aktiv të personave në nevojë. Autoriteti për liçensimin e Agjencive Private të Punësimit është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Inspektorati Shtetëror i Punës i inspekton në mënyrë periodike këto agjensi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 7 Agjensi private të punësimit të liçensuara nga MPCSSH. Nga të cilat 5 operojnë në Tiranë, një në Elbasan dhe një në Shkodër.

## ***2.5 Vet-punësimi***

Me qëllim nxitjen e vetë-punësimit për të patur një të ardhme më të sigurt për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit janë aplikuar disa forma për të mbështetur ato në iniciativa të ndryshme. Një nga këto mënyra ka qene edhe aplikimi i skemës së mikro-kredive nga projekti ILO-MIGRANT. Për zbatimin e këtij programi një kontribut të veçantë kanë dhënë edhe qendrat pritëse dhe riintegruese të viktimave të trafikimit.

Gjatë vitit 2008 nëpërmjet projektit ILO-MIGRANT nga qendra “VATRA” në Vlorë janë trajnuar 10 vajza të cilat kanë qenë të strehuara në këtë qendër. Pas këtij trajnimi janë kualifikuar për të përfituar nga skema e mikro-kredive 4 vajza nga të cilat vetëm njëra ka përfituar ne formë borxhi vlerën prej 400.000 lekë duke e trajtuar si rast të veçantë. Ndërsa 3 vajzat e tjera nuk i kanë pranuar kushtet e kredisë duke i konsideruar normat e interesit relativisht të larta. Në fund të vitit 2008 dhe në fillim të 2009-ës qendra “VATRA” ka fituar një grant me vlerë 1.000.000 lek për ngritjen e mikro-bizneseve. Ky grant është siguruar nëpërmjet Organizatës “Ndihma e Kishës Norvegjeze” dhe është financim i Ministrisë së Jashtme Norvegjeze. Nga ky grant kanë përfituar 5 vajza të cilat kanë qenë të strehuara në qendër. 4 prej tyre janë mbështetur për të ngritur 4 mikro-biznese në zonat rurale dhe një vajzë tjetër është mbështetur pjesërisht për ngritjen e një biznesi në qytetin e Vlorës. Mbështetja ka konsistuar në asistencë dhe dhurim materialesh dhe pajisjesh të cilat do të përdoren për mbarëvajtjen e biznesit. Të gjitha rastet janë në monitorim të vazhdueshëm për një periudhë 3 vjeçare.

Një kontribut të rëndësishëm për punësimin dhe fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave të reja ka dhënë edhe qendra **“Tjetër Vizion”** në Elbasan. Për realizimin e këtij objekti është punuar shumë për rritjen profesionale, orientimin në territor dhe gjetjen e një pune. Për këtë është bërë e mundur që gratë e qendrës që nuk kishin një profesion të mund të ndiqnin një kurs profesional. Kurset e ndjekura kanë konsistuar dhe konsistojnë në parukeri, rrobaqepësi, kuzhinë etj. Marrja e një profesioni nga gratë dhe vajzat përbën një hap të rëndësishëm në një territor që ofron mundësi të pakta punësimi. Në përfundim të kurseve gratë me ndihmën e stafit janë orientuar drejt ndërmarrjeve të ndryshme për gjetjen e një pune. Pjesa më e madhe e grave kanë arritur të punësohen si rezultat i përpjekjeve dhe marrëveshjeve të përbashkëta që **“Tjetër Vizion”** dhe biznese të ndryshme të qytetit aplikojnë dhe vetëm disa prej tyre janë ende në kërkim të një pune.

Për vitin 2007 Tjetër **“Vizion”** eksperimentoi dhe dhënien e mikro-kredive për fuqizimin e grave të cilat shiheshin si të afta në hapjen e një biznesi. Iu dha mikro-kredi një rasti dhune në familje dhe një rasti rrezik trafikimi në shumën 200.000 leke të reja, me një afat shlyerje 1 vit. Rezultoi me shumë vështirësi procesi i shlyerjes së interesit pasi të dyja përfitueset nuk arritën të kishin sukses në treg me mikro-biznesin e tyre, kjo solli dhe shumë vështirësi e probleme në pagesën e interesit.

Bazuar në këtë eksperience dhe në situatën individuale të rasteve nuk u aplikua ky proces për vitet në vazhdim, 2008 dhe 2009.

Gjithashtu edhe qendra **“Të ndryshëm dhe të Barabartë” (D&E)** në Tiranë ka zhvilluar një projekt në bashkëpunim OSBE, ILO dhe Fondin Besa. Këto organizata tentuan për herë të parë skemën e mikro-kredive për ish viktimat e trafikimit. Dhjetë nga përfitueset e D&E dhe disa punonjëse nga stafi i D&E morën pjesë në trajnimin e organizuar nga Fondi Besa (kontraktor i ILO-s dhe OSBE), për shkrimin dhe hartimin e një plani biznesi dhe mënyrat se si mund të hapet një biznes privat. Pas trajnimit u përzgjedhën nga Fondi Besa përfitueset që do mund të përfitonin mikro-kredi nga ky projekt për të hapur një biznes privat. Pasi përgatitën planin e biznesit të ndihmuara nga koordinatori dhe punës, përfitueset në bashkëpunim me Fondin Besa bënë të mundur hapjen e bizneseve të vogla vetjake. Tre nga përfitueset e D&E kanë hapur parukeritë e tyre në qytete të ndryshme të Shqipërisë ku ato jetojnë së bashku me familjet e tyre të origjinës apo dhe me familjet që kanë krijuar vetë, një përfituese tjetër ka hapur një dyqan për të shitur rroba të përdorura, një përfituese ka hapur dyqan rrobash të reja (butik) dhe një tjetër ka hapur dyqan me metrazhe. Gjithsej 6 përfituese të D&E kanë hapur bizneset e tyre. Kjo ishte një mundësi shumë e mirë që iu dha përfitueseve pasi në këtë rast ato jo vetëm që patën të ardhura më të mira, pas kalimit të vështirësive për hapjen e një biznesi të ri, por rritën dhe vetëvlerësimin e tyre nëpërmjet ndërtimit të një biznesi vetjak. Megjithë vështirësitë e hasura, fakti që të gjitha përfitueset vazhdojnë të kenë bizneset e tyre, tregon që ky program ka rezultuar i suksesshëm.

## **2.6 Punësimi jashtë vendit**

Strategjia Kombëtare 2008-2010 kërkon që agjensitë shtetërore të krijojnë mundësi të sigurta dhe të ligjshme për migracion duke rritur kështu numrin e personave të punësuar përmes marrëveshjeve ekzistuese të punësimit me vendet pritëse.

Agjensitë shtetërore shqiptare janë angazhuar për të plotësuar të gjitha kushtet të cilat do të çonin më tej lehtësimin e procesit të migrimin të shtetasve shqiptar jashtë për qëllime studimore apo punësimi, lëvizja e lirë është një instrument shumë i fuqishëm parandalues ndaj fenomenit të trafikimit. Për të përmbushur këtë qëllim MPCSSH B ka dhe vazhdon të negociojë marrëveshje për punësim sezonal (në linjë me Strategjinë Kombëtare për Migracionin) me shtetet evropiane, duke mbajtur parasysh mbrojtjen dhe të drejtat e punëtorëve emigrantë (veçanërisht që lejet e punës të mos jenë të lidhura vetëm me një punëdhënëse) si dhe vazhdon informimin e vazhdueshëm të publikut për procedurat e rregullta të emigrimit për punësim ose motive të tjera në vendet pritëse të tyre.

Në 2 dhjetor të vitit 2008, MPCSSH B nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Italinë lidhur me punësimin e migrantëve shqiptar në Itali. Kjo marrëveshje synon të zgjerojë kanalet e rregullta të emigrimit për punësim në Itali për shtetasit shqiptarë. Këtë vit (2009) pritet të finalizohet një marrëveshje bashkëpunimi me qeverinë greke. Marrëveshja e punësimit me Italinë ndryshe nga marrëveshja e mëparshme ka zgjeruar kategorinë e personave që përfitojnë nga ajo. Përveç punëtorëve sezonalë nga kjo marrëveshje përfitojnë dhe ata që synojnë të emigrojnë për punësim jo sezonal. Përzgjedhja e personave që përfitojnë nga marrëveshja është në bazë të kualifikimeve dhe kriterëve të paraqitura nga punëdhënësit italianë. Kjo sjell dhe rrit nevojën e formimit profesional të kategorive në nevojë duke rritur kështu dhe mundësinë e përfitimit të tyre nga këto instrumente. MPCSSH B në bashkëpunim me IOM , ka punuar në kuadër të projektit “Nxitja e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Migracionit” për hartimin e pamfleteve dhe broshurave informuese për emigrantët shqiptarë në Greqi dhe Itali. Këto informacione i janë drejtuar dhe emigrantëve potencialë në Shqipëri, persona që duan të emigrojnë. Pamfletet dhe broshurat kanë informacione mbi të drejtat dhe detyrimet e shtetasve shqiptarë sipas legjislacionit të këtyre vendeve pritëse, si dhe informacion mbi procedurat e rregullta të punësimit në këto vende. Përveç informacionit drejtuar shtetasve shqiptarë që duan të emigrojnë janë përgatitur manuale informuese dhe pamflete informuese mbi mënyrën dhe procedurat për hyrjen në Shqipëri të shtetasve të huaj për motive punësimi. Është në proces hartimi manuali informues për hyrjen dhe punësimin e shtetasve të huaj në Shqipëri si dhe janë përfunduar një numër i madh pamfletesh informuese për të huajt që kanë informacion për procedurat dhe dokumentacionin që i duhet një të huaji për të hyrë dhe punuar në Shqipëri.

Në zyrat e punësimit janë regjistruar:

### **Për vitin 2008**

- 482 punëkërkues që kërkojnë të emigrojnë për motive punësimi
- 2, që kanë siguruar leje pune jashtë shtetit
- 33 emigrantë të kthyer

### **Tremujori i parë i vitit 2009**

- 203 punëkërkues që kërkojnë të emigrojnë për motive punësimi
- 8 emigrante të kthyer

## **3. Arsimimi**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka vazhduar përpjekjet për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijëve në shkollë, një detyrë e rëndësishme e këtij institucioni. Gjithashtu, institucionalizimi i trajnimit të detyrueshëm kundër trafikimit duke e bërë pjesë të programit bazë të shkollës fillore, të mesme dhe shkollave të tjera para-universitare dhe si pjesë e programit të arsimimit civil dhe gjinor (përfshi edhe çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, të drejtave të fëmijëve, barazisë gjinore dhe dhunës në familje, si edhe edukimin seksual).

### ***3.1 Kurrikulat mësimore dhe temat mbi trafikimin***

Kurrikula shkollore e arsimit parashkollor dhe 9-vjeçar është dokumenti bazë ku mbështetet i gjithë procesi mësimor edukativ në shkollë. Aktualisht, në arsimin bazë, Kurrikula në bazë shkolle lejon trajtimin e tematikave të veçanta, me nxënësit ku natyrshëm përfshihet edhe informacioni për të drejtat e fëmijëve dhe sigurinë e tyre në shkollë dhe jashtë saj. Këtë vit shkollor hyri në fuqi arsimi i detyruar 9-vjeçar dhe u plotësua kurrikula e këtij arsimit. Në vitin 2009, në kuadër të realizimit të projektit “Barazi dhe Cilësi në Arsim” do të zhvillohet nga një konsulent i huaj “Vlerësimi i kurrikulës së arsimit bazë, klasa I – IX. Në përfundim të këtij vlerësimi do të bëhen ndërhyrjet e duhura për të përmirësuar këtë kurrikulë. Ky do të jetë momenti kur do të rishikohet edhe përfshirja e tematikave të mësipërme.

### ***3.2 Pjesëmarrja në arsimin e detyrueshëm***

Në Udhëzimin e fillimit të ri shkollor nr. 32, datë 28.08.2009 udhëzohen të gjitha Drejtoritë Rajonale Arsimore (DAR) dhe Zyrat Arsimore (ZA) të marrin masa për uljen e numrit të nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe që kanë tendenca braktisjeje. Në zbatim të këtij udhëzimi në të gjitha Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe Zyrat Arsimore të



vendit janë planifikuar dhe realizuar trajnime me mësues që punojnë me nxënës që kanë braktisur shkollën dhe që kanë tendenca braktisjeje.

Në nivel klase, shkolle, atje ku problemi i braktisjes është prezent, mësuesit punojnë me programe të veçanta pune me qëllim që të sensibilizojnë prindërit për rëndësinë e shkollimit. Sektorët e Inspektimit në DAR inspektojnë të paktën dy herë në vit çdo ZA dhe shkollë që ka nxënës braktisës apo jashtë sistemit arsimor.

Në çdo DAR/ZA është ngarkuar një specialist që të merret me problemet e arsimimit të shtresave të marginalizuara. Ky specialist harton një plan pune dhe raporton dy herë në vit, me shkrim për realizimin e tij. Drejtori i DAR/ZA dërgon dy herë në vit, pranë Drejtorisë së Kurrikulës dhe Monitorim Vlerësimit (DKMV) MASH, një progres raport për realizimin e planit të punës dhe problemet që kërkojnë ndërhyrje jashtë kompetencave të tyre, me qëllim zbutjen e fenomenit të analfabetizmit dhe braktisjes shkollore.

MASH ka punuar për hartimin dhe zbatimin e programeve për arsim alternativ dhe përvetësim të aftësive jetësore për fëmijët jashtë shkollave (përfshirë fëmijët e rrugës, romët, fëmijët me nevoja të veçanta, etj.) dhe për jetimët (banorë dhe ish-banorë të shtëpive të fëmijës) që përgatiten për t'u larguar. Për të përmbushur këtë qëllim MASH ndjek realizimin e Projektit të "Shansit të dytë". Në këtë kuadër DAR dhe ZA raportojnë dy herë në vit për funksionimin e klasave të shansit të dytë.

Në të gjithë vendin ka rreth 513 nxënës që ndjekin klasat e shansit të dytë në 29 shkolla. Mësimi që zhvillohet me këta fëmijë është plotësues, për të kapërcyer mangësitë që kanë dhe për ti ri-integruar në klasat e rregullta.

### ***3.3 Sistemi i "mbrojtjes të fëmijëve" në shkolla***

Një rëndësi të veçantë Strategjia i jep institucionalizimit të një sistemi të "mbrojtësve të fëmijëve" në shkolla (bazuar në praktikat më të mira të TdH, ILO-IPEC, UNICEF, WV etj.); duke rritur kështu përkrahjen dhe këshillimin ndaj fëmijëve/të rinjve, për të dalluar rastet në rrezik dhe për të marrë masa me NjPF-të (Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve). Për këtë qëllim në prill të vitit 2008 me Urdhrin nr. 170 dhe Udhëzimin nr 18, datë 21.04.2008, "Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar", të Ministrit të Arsimit, u legjitimua shtrirja e shërbimit psikologjik shkollor në arsimin para-universitar, kopshte dhe shkolla. Pranë çdo shkolle ku funksionon Shërbimi Psikologjik Shkollor (SHPSH), në ndihmë të psikologut është ngritur grupi mbështetës i psikologut që përbëhet nga drejtori, dy mësues dhe psikologu. Në nivel shkolle ky është grupi që trajton problemet e fëmijëve në rrezik trafikimi. Aktualisht SHPSH shtrihet në të gjitha shkollat dhe kopshtet e qytetit dhe pjesërisht edhe në fshat. Deri tani janë të punësuar gjithsej 190 psikologë të cilët mbulojnë këtë shërbim 1 psikolog për 2500 nxënës për shkollat 9-vjeçare, për 2000

nxënës për shkollat e mesme dhe 1700 për shkollat me profil të veçantë. Në të gjithë vendin janë gjithsej 1477 shkolla me arsim 9-vjeçar, nga të cilat 1172 në fshat dhe 305 në qytet. Janë gjithsej 380 shkolla të mesme, 150 në qytet dhe 230 në fshat.

Në kuadër të marrëveshjes që MASH ka me Terre des Hommes, në 5 Drejtori Rajonale Arsimore (DAR) të vendit po zhvillohet projekti "Përforcimi i rolit të shkollës në mbështetjen dhe mbrojtjen e fëmijëve brenda mjediseve të shkollës." Është hartuar manuali për mbrojtjen e fëmijëve dhe po zbatohet jo vetëm në shkollat e këtyre 5 DAR por dhe më gjerë. Në projekt janë përfshirë 160 shkolla 9-vjeçare.

Janë zhvilluar:

- 147 seanca sensibilizuese me prindërit ;
- 720 seanca sensibilizuese dhe këshilluese me nxënësit ;
- 964 dosje janë hapur për fëmijët me probleme të mbrojtjes ;
- 13 fëmijë janë referuar tek strukturat e tjera lokale si Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki, qendra shëndetësore etj ;
- 185 vizita janë kryer në familjet e fëmijëve me probleme.

MASH po punon që përvojën e mirë të krijuar në këto shkolla ta shtrijë më tej.

#### **4. Regjistrimi i popullsisë**

Gjatë këtyre dy dekadave të fundit shtetasit shqiptar kanë patur probleme serioze me regjistrimin e tyre, qytetari shqiptar nuk ka disponuar një dokument zyrtar kombëtar i cili të përmbante informacion mbi personin. Duke pasur parasysh lëvizjen e brendshme migratore të shqiptarëve një regjistrim i tillë ka qenë shumë i rëndësishëm. Në vitin 2008 u realizua krijimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Ky regjistër do të jetë burimi i vetëm i të dhënave për shtetasit shqiptar. Ky entitet do të bëjë të mundur pasqyrimin e drejtpërdrejt të informacionit për çdo shtetas shqiptar në çdo dokument të plotësuar dhe lëshuar nga shërbimi i gjendjes civile. Regjistri Kombëtar si i vetmi burim të dhënash për shtetasit, rrit cilësinë e shërbimit dhe garancinë në cilësinë e saktësinë e të dhënave.

Shërbimi i gjendjes civile gjatë kësaj periudhe, përveç krijimit të RKGJC-së, është duke krijuar, në bashkëpunim me bashkitë/komunat edhe Regjistrat Vendor të adresave, të cilat do të jenë baza për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Adresave.

Përveç këtij procesi, shërbimi i gjendjes civile ka treguar një vëmendje të veçantë edhe plotësimin të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me procesin e regjistrimit dhe çregjistrimit të shtetasve. Për këtë qëllim është miratuar nga Parlamenti Shqiptar ligji i ri, Nr. 10129, date 11. 05. 2009 "Për Gjendjen Civile". Ky ligj bën të mundur përmirësimin e procedurave për regjistrimin e lindjeve, duke bërë të mundur heqjen e

pengesave ligjore, si p.sh. kalimin e afatit prej 45 ditë nga dita e lindjes dhe vërtetimin e faktit të lindjes nëpërmjet gjykatës, pas kalimit të këtij afati.

Gjithashtu, procedurat për regjistrimin e lindjeve në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore kanë qenë dhe janë të parashikuara në ligjin për gjendjen civile. Në ligjin e ri është parashikuar që regjistrimi i akteve të lindjes të mund të behet dhe on-line nga këto zyra.

#### ***4.1 Regjistrimi i Komunitetit Rom***

Komuniteti Rom është komuniteti me problemet më të mëdha të regjistrimit të shtetasve në vend. Si pjesë e procesit të regjistrimit të popullsisë një rëndësi të veçantë i është dhënë regjistrimit të komunitetit Rom. Për realizimin e procesit të pajisjes së shtetasve romë me letërnjoftim Qeveria Shqiptare ka marrë angazhim për pajisjen e tyre me këtë dokument falas. Ky angazhim është formalizuar në Vendimin Nr. 336, datë 15/04.2009, "Për kompensimin e pagesës për pajisjen me letërnjoftim të shtetasve në nevojë".

Për të përmirësuar procedurat e regjistrimit të lindjeve është ndërmarrë një iniciativë ligjore me anën e së cilës përmirësohet procedura e regjistrimit; është hequr afati kohor prej 45 ditësh dhe pas kalimit të këtij afati personat e interesuar duhej të paraqiteshin në gjykatë për të vërtetuar faktin e lindjes.

Pra sot jo vetëm që nuk ka afat kohor i cili po të kalohet sjell pasoja administrative, por ligji parashikon bonus prej 5000 lekë për të gjithë familjet që regjistrojnë lindjet brenda 60 ditëve. Kalimi i këtij afati nuk detyron që të bësh vërtetimin e lindjes në gjykatë, por regjistrimi vazhdon në rrugë administrative. Për të regjistruar një lindje, tashmë nuk është lënë vetëm në vullnetin e shtetasve të interesuar por ligji ngarkon me përgjegjësi të gjitha institucionet publike dhe jo publike, që kanë detyrë për lindjen që të bëjnë njoftimin e lindjes në zyrën e gjendjes civile përkatëse/DPGJC. Kjo masë për më së shumti ka ndihmuar kategorinë e romëve të cilët për arsye nga më të ndryshmet nuk kryenin regjistrimin në kohën e kufizuar që parashikonte ligji dhe akoma më tepër kur vinte puna për ta vërtetuar lindjen me vendim gjykate. Nga ana tjetër, Ministria e Brendshme ka hartuar një projekt "Për identifikimin dhe regjistrimin e romëve të paregjistruar". Ky projekt ka në themel një lloj "CENSIUSI" në zonat ku banojnë romët dhe do të kryhet në bashkëpunim të plotë me shoqatat Rome.

## **5. Shfrytëzimi i punës së fëmijëve**

Krijimi i një sistemi monitorues shumë-disiplinor për mbrojtjen e fëmijëve, dhe specifikisht mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi për punë, ka qenë një objekt i rëndësishëm i punës së Njesisë Antitrafik. Njësia Antitrafik është përpjekur të

ndërgjegjësojë agjensitë shtetërore mbi këtë fenomen të rëndë social, shfrytëzimi i punës së fëmijëve si policia, inspektorët e punës, strukturat e qeverisjes vendore, OJF-të e komunitetit për të identifikuar fëmijët e shfrytëzuar apo në rrezik shfrytëzimi.

Në kuadrin e Memorandumit të Mirëkuptimit që MPCSSHB ka nënshkruar me ILO (Organizatën Ndërkombëtare të Punës) është miratuar Projekti: "Sistemi i Monitorimit të Punës së Fëmijëve në Shqipëri", i cili do të pilotohet në pesë Bashki: Tiranë, Korçë, Berat, Elbasan dhe Shkodër me qëllim parandalimin e fenomenit dhe mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në punë të rrezikshme. Në këtë kuadër në tre Drejtoritë Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Punës: Tiranë, Korçë dhe Berat do të krijohen komitetet lokale me synim parandalimin e fenomenit të punës së fëmijëve, tërheqjen nga puna të fëmijëve që punojnë duke siguruar alternativa më të përshtatshme dhe në interes të tyre.

### **5.1 Inspektoriatit Shtetëror i Punës (ISHP)<sup>13</sup>:**

Një nga objektivat e Inspektoriatit Shtetëror të punës është kontrolli i punës së fëmijëve. Nga inspektimet e kryera në periudhën shtator 2008 – Prill 2009 rezultojnë të dhënat si më poshtë vijon.

**Sipas moshës** rezultojnë se fëmijë të evidentuar në punë janë kryesisht ata të moshës:

- 17-vjeç me 54.3%
- 16-vjeç me 18.3%
- 15-vjeç me 1.9%

Nga fëmijët e evidentuar në punë rezultojnë se pjesa më e madhe është e seksit femër dhe konkretisht , 82.6% e të gjithë fëmijëve janë vajza.

**Fëmijë të punësuar sipas llojit të aktivitetit:**

- Bujqësi, Pyje, Peshkim - 23%
- Ndërmarrje Prodhuese – 63.7% ( Rrobaqepësi - 49.5 Faqe këpucësh -15.7%)
- Ndërtim - 1.8%
- Aktivitete të tjera - 11.5%

Gjatë inspektimeve rezultojnë se janë evidentuar 86% e fëmijëve që punojnë të siguruar dhe 14% e tyre nuk ishin të siguruar në momentin e kontrollit. Sigurisht që për këta fëmijë janë marrë masat për sigurimin e tyre pranë zyrave të tatim-taksave. 78% e fëmijëve të evidentuar janë me ekzaminim mjekësor. Për pjesën tjetër janë informuar

---

<sup>13</sup> Burimi i të dhënave: Inspektoriatit Shtetëror i Punës

punëdhënësit dhe janë lënë detyra konkrete në lidhje me ekzaminimin mjekësor në varësi të vendit të punës, ku punojnë këta fëmijë.

**Arsimimi** i fëmijëve të punësuar:

Nga fëmijët e evidentuar rezultojnë:

- 5.4% me arsim fillor
- 90% me arsim 8-vjeçar
- 4.6% me arsim të mesëm

**Masat që janë marrë nga ISHP-ja.**

Në kuadër të ndryshimeve që do të pësoje kodi i punës janë përgatitur 2 (dy) projekt-vendime:

1. Për përcaktimin e kontrollit mjekësor për punëmarrësit e mitur nën 18-vjeç para fillimit të marrëdhënieve të punës;
2. Si dhe vendimi i dytë ka të bëjë me përcaktimin e orëve të punës të cilët s' duhet të kalojnë 48 orë në javë përfshirë në këtë dhe orët suplementare në vendet e punës që paraqesin rrezik.

Në dokumentin politik të strategjisë dhe shëndetit në punë është parë me prioritet mbrojtja e kësaj kategorie të punësuarish.

Në projekt-ligjin që po përgatitet (për sigurinë dhe shëndetin në punë), janë parashikuar dispozita të veçanta për mbrojtjen e të miturve në punë si dhe parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Është zhvilluar një tryeze e rrumbullakët për mbrojtjen e të miturve në punë ku marrin pjesë përfaqësues të sindikatës, të konfederatës të punëdhënësve, punëmarrësve.

## **6. Ambasadat shqiptare si mekanizma ndihmës në parandalimin e rasteve të trafikimit**

Janë trajnuar punonjësit e konsullatave në mënyrë që ata të jenë në gjendje të evidentojnë imigrantët të cilët mund të jenë në rrezik dhe të japin informacion pa shkelur të drejtat e njeriut, apo të tërheqin vizat e tyre për dyshim trafikimi. Janë përgatitur broshura informative lidhur me shërbimet që u ofrohen shtetasve nga përfaqësitë tonë (në bashkëpunim me IOM) në kuadrin e fushatës informative të parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Migracionin.

Vazhdimi i funksionimit të linjës kombëtare telefonike falas dhe bashkëpunimi me linjat telefonike për dhunën në familje, për të përfshirë ndërgjegjësimin mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe shërbimet në dispozicion. Pranë sektorit të Marrëdhënieve me Publikun në Dr. Konsullore është parashikuar vendosja e një numri telefoni, për kontakte direkte me publikun. Sektori në fjalë është, ndërkohë, aktivisht i përfshirë në trajtimin apo paraqitjen e dërgesave, rasteve dhe denoncimeve të mundshme.

## **7. Ngritje kapacitetesh për forcimin e mekanizmave koordinues dhe referues për identifikimin e personave në rrezik në nivel lokal**

Strategjia kërkon që të institucionalizohen mekanizmat mbrojtjes, dhe parandalues si dhe mekanizmat e përkrahjes në nivel vendor për grupet në nevojë dhe në rrezik trafikimi. Strategjia parashikon krijimin dhe forcimin e mekanizmave koordinues dhe referues për identifikimin e personave në rrezik dhe sigurimin e ndërhyrjeve parandaluese dhe mbështetëse si pjesë e “Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Për të siguruar një mbrojtje/mbështetje sa më të mirë të personave të kategorisë në rrezik trafikimi, është e domosdoshme siguri i shërbimeve të përshtatshme dhe të mbështetjes për grupet dhe personat në nevojë dhe në rrezik.

Koordinatori Kombëtar dhe Njësia Antitrafik kanë bërë të mundur zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme për ta arritur sensibilizimin e të gjitha subjekteve më të mëdha shtetërorë të shërbimeve për çështjet e anti-trafikimit (policia, subjektet e qeverisjes vendore, punonjësit socialë, etj. Më shumë duhet bërë për të siguruar që çështjet e anti-trafikimit të përfshihen në veprimtaritë e rregullta të agjensive të ndryshme, si pjesë e termave të referencës. Termat e referencës të përfshijnë asistencë për personat e trafikuar dhe grupet në rrezik.

## **8. Aktivitetet lokale - Komitetet Rajonale Anti-Trafik (KRAT)**

Gjatë vitit 2008 dhe në vazhdim, është kërkuar sistematikisht nga Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore që autoritetet vendore jo vetëm të identifikonin numrin e familjeve me probleme sociale dhe fëmijët të cilët kanë braktisur shkollën, por dhe të bëjnë një analizë të shkaqeve, dhe më pas në bazë të rezultateve të analizës të identifikojnë masat të cilat duhen marrë për të përmirësuar situatën.

KRAT-et nëpërmjet Drejtorive Arsimore kanë përcjellë informacion pranë ZKKA-së për numrin e fëmijëve që kanë braktisur shkollën, shkaqet, si dhe masat e marra për përfshirjen e tyre në shkollë. Një punë e mirë në këtë drejtim është bërë në të gjitha qarqet e vendit në zbatim edhe të programit të MASH “Shansi i dytë”. Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe Zyrrat Arsimore kanë punuar me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit

nëpërmjet procesit mësimor – edukativ për ndalimin e fenomenit të trafikimit, përmes pjesëmarrjes aktive të nxënësve duke pasur si prioritet respektimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë.

Gjithashtu, është punuar edhe me programe të veçanta për arsimin alternativ duke përfshirë fëmijët e rrugës, romët, fëmijët me nevoja të veçanta, jetimët etj. Një ndihmesë të madhe në veprimtarinë e KRAT – ve kanë dhënë edhe Qendrat dhe OJF-të të cilat në veprimtarinë e tyre kanë në fokus parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi nëpërmjet seancave edukuese me të rinj në të cilat janë trajtuar tema të ndryshme mbi dhunën në familje, trafikimin, diskriminimet, paragjykimet, droga, etj. Është dhënë ndihmë dhe këshillim në shkollat që kanë fëmijë nga komuniteti rom, apo dhe fëmijët e rrugës, të punësuar në punë të zezë etj. Në vitin shkollor 2008-2009, Drejtoritë Arsimore në të gjitha qarqet kanë marrë masa për ngritjen dhe vënien në funksionim të linjave që bëjnë transportin e nxënësve për në shkollë dhe anasjelltas.

Për sa i përket ndërgjegjësimit publik KRAT-et kanë zhvilluar një sërë aktivitete të ndihmuar edhe nga OJF-të dhe mediat lokale. Janë zhvilluar debate televizive kundër dhunës në familje dhe për probleme të tjera lidhur me trafikimin. Janë zhvilluar fushata për ndërgjegjësimin sidomos për grupet e veçanta (Romët, fëmijët e rrugës, gratë dhe vajzat e reja si dhe familjet me probleme social-ekonomike). Janë publikuar dhe janë shpërndarë materiale dhe fletëpalosje me tematikë edukuese dhe ndërgjegjësuere.

Punësimi është një instrument shumë i rëndësishëm parandalues për fenomenin e trafikimit. Komitetet Rajonale Antitrafik dhe përkatësisht Zyrat Rajonale të Punës (të përfaqësuara në Komitetet Rajonale Antitrafik) duhet të kenë informacion të përditësuar mbi numrin e personave të cilat janë identifikuar si të papunë dhe në bashkëpunim me MPCSSH të hartojnë programe të cilat nxisin punësimin dhe rrisin aftësitë për punë të punëkërkuësve në vend. KRAT-et nëpërmjet Zyrave Rajonale të Punësimit i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë si monitorimit dhe vlerësimit të tregut të punës ashtu edhe identifikimit të personave të papunë si dhe janë marrë masa për punësimin e punëkërkuësve të papunë në mënyrë të veçantë punëkërkuëset e papunë femra që janë edhe më të rrezikuara nga trafikimi. Zyrat Rajonale të Punësimit në bashkëpunim edhe me anëtarët e tjerë të KRAT-eve kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur kapacitetin dhe efikasitetin e tyre për trajnimin dhe formimin profesional të personave duke pasur parasysh nevojat e tregut të punës.

## **9. Aktivitete të tjera**

### **9.1. Dita kombëtare Antitrafik- 18 Tetor, 2008**

Në ditën Kombëtare Antitrafik, 18 Tetor 2008, Koordinatori Kombëtar Antitrafik dhe Njësia Antitrafik organizuan një aktivitet publik me moton: *Trafikimi është një rrugë pa*

*kthim. Thuaj jo trafikimit.* Ky aktivitet u transmetua gjerësisht nga kanalet televizive më të mëdha të vendit. Në këtë aktivitet morën pjesë shumë aktorë antitrafik dhe studentë.

## **9.2. Linja telefonike pa pagesë 0 800 1212**

Linja telefonike pa pagesë 0 800 1212 e vënë në funksion në Nëntor të vitit 2006, funksion plotësisht, duke shërbyer jo vetëm si një mjet informues publik mbi migracionin e rregullt, por edhe si mjet parandalues për rastet e trafikimit në vend.

## **9.3. Stendat në Pikat kufitare**

Me ndihmën e OSBE dhe Këshillit të Evropës në pjesën më të madhe të pikave kufitare janë vendosur stenda dhe postera.

## **9.4 Promovimi për zbatimin e Kodit të Sjelljes në Turizëm**

Shqipëria nuk regjistron asnjë rast të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në turizëm, por megjithatë tashmë në Shqipëri janë ngritur të gjithë mekanizmat e nevojshëm për identifikimin e këtyre rasteve dhe referimin e tyre. Në vitin 2007, Ministria e Brendshme ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe OSBE-në “Për Promovimin dhe Zbatimin e Kodit të Sjelljes për Parandalimin e Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve në Turizëm”. Pas nënshkrimit të këtij dokumenti, 22 operatorë turistik (agjensi turistike dhe hotele), nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi për implementimin e kodit në aktivitetet e tyre. Ministria e Turizmit ka iniciuar ngritjen e një grupi ndërministror pune i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit të Sjelljes. Grupi do të përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, MPCSSH dhe Shoqatës Shqiptare të Turizmit.

Operatori nënshkruar ka detyrimin të vendos një politikë etike të kompanisë lidhur me shfrytëzimin seksual të fëmijëve për qëllime përfitimi, të trajtojë personelin turistik, të prezantojë një pikë në kontrata me furnitorët ku bashkërisht dënohet shfrytëzimi seksual i fëmijëve për qëllime përfitimi, ti siguroj informacion udhëtarëve nëpërmjet katalogëve, broshurave, filmave në udhëtim etj në lidhje me problemin, të siguroj informacion për personat e kontaktit mbi Kodin e Sjelljes, si dhe të raportoj çdo vit mbi zbatimin e Kodit të Sjelljes për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual në turizëm.

Një mesazh televiziv i Koordinatorit Kombëtar Antitrafik mbi turizmin seksual me fëmijë u transmetua në kanalet televizive kryesore në vend i cili vazhdon të ritransmetohet në sezonet e pikut turistik dimëror dhe veror.



## KONKLUZIONE

Siç shihet edhe nga përmbajtja e këtij raporti, nga viti në vit, në vend janë shënuar arritje dhe janë realizuar objektiva të dukshme në parandalimin dhe në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo ka ardhur si rezultat i përpjekjeve dhe një pune të vazhdueshme nga të gjitha strukturat dhe agjensitë përgjegjëse duke filluar nga ato shtetërore si dhe aktorëve të tjerë përfshirë edhe OJF-të dhe Organizatat Ndërkombëtare.

Pavarësisht arritjeve të dukshme të cilat janë të shprehura qartë edhe në raport, zbatimi i plotë i Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore ka hasur në probleme dhe vështirësi, duke na vënë përballë sfidave dhe objektivave të tjera akoma më të vështira, të cilat vijnë si detyra për t'u realizuar në të ardhmen. Në këtë kontekst duke reflektuar edhe gjetjet nga ky raport të gjitha strukturat përgjegjëse sidomos ato shtetërore por edhe agjensitë e tjera duhet t'i orientojnë përpjekjet e tyre në realizimin e të gjitha atyre objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara në Strategji duke e vënë theksin në këto drejtime kryesore:

- Marrja e masave për realizimin e aktiviteteve antitrafik të paraqitura në Strategji nga të gjitha institucionet zbatuese dhe mbështetëse brenda afateve të paracaktuara nga kjo Strategji;
- Raportim i herëpashershëm pranë Zyrës së Koordinatorit Kombëtar jo vetëm për progresin e arritur, por edhe për vështirësitë e hasura dhe rekomandime për përmirësimin e situatës;
- Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në mënyrë të veçantë përsa i përket mbrojtjes së viktimave të trafikimit nëpërmjet një sistemi efikas dhe të sigurtë i cili garanton zbatimin e standardeve të kërkuara ndërkombëtare;
- Forcimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të duhura për ushtrimin e ndjekjes penale, mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin nga trafikimi nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të të gjitha strukturave dhe punonjësve në këtë fushë, rritja e profesionalizmit dhe cilësisë së shërbimeve ndaj viktimave të trafikimit;
- Forcimi i mekanizmave ekzistues dhe krijimi i mekanizmave të reja duke e vënë theksin në ato në nivel vendor për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe integrimin e plotë dhe të sigurtë të viktimave të trafikimit;
- Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i shoqërisë për çështjet e anti-trafikimit në mënyrë të veçantë i grupeve dhe individëve më të rrezikuar duke synuar rritjen e mirëqenies dhe harmonisë sociale si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës;
- Përmirësimi i koordinimit dhe forcimi i bashkëpunimit me të gjithë aktorët në mënyrë të veçantë me OJF-të dhe Organizatat Ndërkombëtare aktive në këtë fushë, si një ndër elementët kyç në reagimin anti-trafik;

- Rritja e bashkëpunimit me vendet e tjera si një domosdoshmëri për të qenë të suksesshëm në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, krijimi dhe forcimi i instrumenteve të bashkëpunimit nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve ekzistuese dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të reja.

## ANEKS 1

### Shpërndarja gjeografike e gjyqtarëve të trajnuar për çështje që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore sipas rretheve gjyqësore

#### Moduli Nr. 1

Tematika e Trajnimit	Rrethi gjyqësor	Nr. i Gjyqtareve të trajnuar	Nr. i Prokuroreve të trajnuar	Nr. i Oficerëve të Policisë Gjyqësore	Totali
Tema 1 (moduli 1): <b>Kompensimi i viktimave të trafikimit</b> (të drejtat e viktimave të trafikimit), Vështrim krahasues: e drejta për kompensim, e drejta ndërkombëtare dhe ajo e krahasuar. Ligji shqiptar dhe përvoja e organeve të drejtësisë – ligji penal, civil dhe i punës.	Berat	5	2	-	7
	Peshkopi	2	3	-	5
	Durrës	3	2	-	5
	Elbasan	5	2	-	7
	Fier	1	1	-	2
	Gjirokastrë	4	1	-	5
	Kavajë	5	2	-	7
	Korçë	1	2	-	3
	Krujë	1	1	-	2
	Kukës	1	1	-	2
	Kurbin	6	2	-	8
	Lezhe	1	3	-	4
	Lushnjë	1	1	-	2
	Mat	2	1	-	3
	Pogradec	3	2	-	5
	Puke	3	2	-	5
	Sarandë	2	1	-	3
	Shkodër	1	1	-	2
	Tiranë	1	5	8	14
	Tropojë	2	2	-	4
	Vlorë	3	2	-	5
	Krimet e Rënda	2	2	-	4
	Apeli Tiranë	1	2	-	3
	Apeli Shkodër	-	1	-	1
	Apeli Durrës	4	2	-	6
	Apeli Gjirokastrë	-	2	-	2
	Apeli Vlorë	-	1	-	1
	Apeli Korçë	5	1	-	6
	Apeli Kr. Të Rënda	-	1	-	1
	<b>Totali i të trajnuarve për temën e kompensimit</b>		<b>65 gjyqtare</b>	<b>51 prokurore</b>	<b>8 Oficerë të Policisë Gjyqësore</b>

**Moduli Nr. 2**

Tematika e Trajnimit	Rrethi gjyqësor	Nr. i Gjyqtareve të trajnuar	Nr. i Prokuroreve të trajnuar	Nr. i Oficereve të Policisë Gjyqësore	Totali
Tema 2 (moduli 2): Identifikimi, trajtimi dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore para dhe gjate procesit gjyqësor.	Berat	2	1	-	3
	Peshkopi	2	-	-	2
	Durrës	1	1	-	2
	Elbasan	-	3	-	3
	Fier	2	-	-	2
	Gjirokastrë	1	1	-	2
	Kavajë	-	3	-	3
	Korçë	2	1	-	3
	Krujë	2	2	-	4
	Kukës	-	-	-	-
	Kurbin	-	3	-	3
	Lezhë	1	2	-	3
	Lushnje	1	-	-	1
	Mat	-	-	-	-
	Pogradec	-	1	-	1
	Pukë	-	2	-	2
	Sarandë	1	-	-	1
	Shkodër	2	1	-	3
	Tiranë	11	17	6	34
	Tropojë	-	-	-	-
	Vlorë	1	-	-	1
	Krimet e Rënda	5	-	-	5
	Apeli Tiranë	-	-	-	-
	Apeli Shkodër	-	-	-	-
	Apeli Durrës	-	2	-	2
	Apeli Gjirokastrë	-	-	-	-
	Apeli Vlorë	2	-	-	2
Apeli Korçë	-	-	-	-	
Apeli Kr. Të Rënda	3	1	-	4	
<b>Totali i temës së dytë</b>		<b>39 gjyqtarë</b>	<b>41 prokurore</b>	<b>8 Oficerë të Policisë Gjyqësore</b>	<b>86</b>
<b>Totali i dy temave</b>		<b>104 gjyqtarë</b>	<b>92 prokurore</b>	<b>14 oficere</b>	<b>210</b>

## ANEKS 2

### Llojet e shërbimeve të ngritura sipas qarqeve

Nr.	Qarku	Faza e Parë	Faza e Dytë	Totali
1	Shkodër	<ol style="list-style-type: none"> <li>Qendër komunitare multidisiplinare, Shoqata Gratë pa përkrahje, (Komuna Bushat – Shkodër).</li> <li>Qendër sociale në mbështetje të fëmijës dhe familjes në vështirësi, Shoqata Every Child- Shkodër.</li> <li>Qendër ditore e hapur, Shoqata "The Door".</li> <li>Qendër multidisiplinare për të moshuar. Shoqata Dimension Human-Shkodër.</li> <li>Qendër Komunitare për Zhvillim dhe Integrim, Bashkia Pukë</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Qendër multidisiplinare për fëmijët dhe gratë në risk, Misionaret e shërbimeve sociale (Vau i Dejës).</li> <li>Qendër sociale për gra në vështirësi, Shoqata Gruaja në zhvillim.</li> <li>Të paaftë në nevojë, SHNKSH, Bashkia Pukë.</li> </ol>	8
2	Lezhë		<ol style="list-style-type: none"> <li>Qendër sociale për mbështetje dhe të ardhme për të rinjtë në risk, Shoqata Gratë mbështesin gratë.</li> <li>Ndihmë dhe mbështetje për gratë dhe të rinjtë në nevojë, Shoqata Gruaja kryefamiljare (Bashkia Laç).</li> </ol>	2
3	Bashkia Tiranë	<ol style="list-style-type: none"> <li>Të qëndrojmë së bashku, Shoqata Gratë dhe Fëmijët – Kombinat;</li> <li>Qendër komunitare multidisiplinare për fëmijët dhe familjen, Every Child-Tiranë.</li> <li>Qendër komunitare për të moshuar, Shoqata Gruaja në zhvillim.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Qendër shërbimesh psiko-sociale për njerëzit në nevojë "Mos vuani në heshtje", Shoqata shqiptare e trajtimit të dhimbjes.</li> <li>Porta parandaluese Hiv Aids, APRAD.</li> <li>Krijimi i qendrës komunitare, social kulturore rinore "Foris", Foris.</li> <li>Shtëpi e përbashkët, Shoqata "Shpresë dhe dashuri".</li> </ol>	7
4	Qarku Tiranë	<ol style="list-style-type: none"> <li>Qendër për Zhvillimin e Gruas, Fondacioni për biznesin e vogël (Komuna Vaqar).</li> <li>Qendër komunitare multidisiplinare, Shoqata Gruaja për Veprim Global (Bashkia Kamëz).</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Qendër komunitare për integrim dhe zhvillim, Bashkia Rrogoshinë.</li> <li>Qendër komunitare për të rinjtë dhe të moshuarit në risk, Komuna Luz i vogël, Kavajë.</li> </ol>	5

RAPORTI PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE  
 NJERËZORE 2008-2010  
 Shtator 2008 – Maj 2009

		3. Qendër për shërb social-ekon. e shënd. Shoqata Media sociale & mbështetja psiko-sociale (Komuna Kërrabë).		
5	Durrës	1. Qendër ditore për të moshuarit dhe të rinjtë në risk. Shoqata për mbrojtjen nga dëmtimet prej armeve ( Bashkia Fushe - Kruje)	2. Rehabilitimi dhe riorganizimi shërbimeve sociale ne qendrën ditore te moshuarve, Bashkia Durrës. 3. Biblioteka audio për te verbrit, Instituti shqiptar i marrëdhënies publike. 4. Qendër multidisiplinare për fëmijët jetim dhe gratë e veja, Shoqata Mbështetje për adoleshentet & EDA (Komuna Kodër Thumanë). 5. Qendër shërbimesh sociale, Komuna Maminas	5
6	Fier		1. Aktive në çdo moshë, Shoqata Kërkim në komunitet, (Bashkia Patos). 2. Qendra ditore e shërbimeve sociale dhe mbijetesës në familje për komunitetin rom, Shoqata shqiptare e Ambientalisteve dhe Mirëqenies sociale (Komunë Qendër Fier)	2
7	Vlorë	1. Qendër shërbimesh për të rinjtë dhe të moshuarit, Bashkia Orikum. 2. Qendër ditore për fëmijë, Shoqata Fëmija në Fokus. 3. Qendër multidisiplinare për të moshuar, Shoqata të moshuar të vetmuar. 4. Qendër për shërbime sociale të integruara, Qendra për Popullsi dhe Zhvillim	1. Qendër komunitare multidisiplinare, Bashkia Delvinë. 2. Qendër e shërbimeve sociale për grupet në nevojë, Rrjeti i agjensive rajonale të zhvillimit ( Bashkia Vlorë). 3. Qendër multidisiplinare për të moshuarit, Komuna Ksamil.	7
8	Gjirokastrë		1. Të bëjmë gjithçka për cilësinë e jetës, Shoqata kombëtare e kujdesit onkologjik dha paliativ. 2. Qendër Multidisiplinare për Zhvillim dhe Integrim, Bashkia Memaliaj. 3. Qendër Zhvillimi dhe Integrimi, Komuna Antigone	3
9	Elbasan			1
10	Bashkia Poliçan		1. Fëmijëri pa gjakmarrje, Qendra për edukimin arsimor e social të	1

RAPORTI PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE  
 NJERËZORE 2008-2010  
*Shtator 2008 – Maj 2009*

			fëmijëve të ngjuar e në nevojë	
11	Bashkia Berat		1. Qendra LIRA, Bashkia Berat.	1
12	Bashkia Kukës		1. Përmirësimi i cilësisë së jetës të grupeve vulnerabël nëpërmjet lëvrimin të shërbimeve sociale në komunitet, Bashkia Kukës.	1
				<b>43</b> <i>shërbime</i>